

Doracak për [[wiki]]



МЕТАМОРФОЗИС 

Përmbajtja

1. Wiki-teknologjia	9
Ç'është wiki?	9
Wiki paraqet një sistem për menaxhim me përmbajtje	9
Wiki është bashkëpunim për përmbajtje	11
Përfundim	12
Ç'mund të bëjnë wiki-t për Ju	12
2. Redaktimi	13
Dritarja për lexim.....	13
1. Redaktimi Juaj i parë.....	14
Pasqyra e ndryshimeve	15
Përshkrimi i ndryshimeve.....	16
Ruajtja e faqes	17
Shënimi i ndryshimit të vogël	17
Cilat ndryshime duhet t'i shënoni si të vogla	18
Çka duhet të mbajmë në mend	18
Paraqitja e ndryshimeve	19
2. Historia e redaktimeve	20
Formatimi i tekstit	20
Shkronjat e trasha dhe kurzive (të pjerrëta).....	20
Trashja dhe pjerrësimi (bërja kurziv) nëpërmjet shiritit me vegla për redaktim	20
Ku përdoret më shpesh teksti i trashur dhe i pjerrët	21
Shtimi i titujve dhe nëntitujve.....	21
Shtimi i pjesës së re nëpërmjet shiritit me vegla për redaktim.....	24
Tabela me përmbajtje	24
Pjesët e veçanta mund të redaktohen veç e veç	25
Shtimi i një pjese të re në fund të faqes.....	26
Shtimi i vijës horizontale	27
Shkruarja e tekstit në rresht të ri.....	27

Rreshti i ri nëpërmjet shiritit me vegla për redaktim.....	28
Tërheqja e rreshtave në të djathtë	29
Tërheqja e tekstit nëpërmjet shiritit me vegla për redaktim	29
Ndarja e një blloku me tekst	30
Krijimi i listave.....	31
Krijimi i listave nëpërmjet shiritit me vegla për redaktim.....	34
Futja e shenjave speciale	35
3. Linket	38
Linket e brendshme	38
Si krijohen linket e brendshme?.....	38
Linket e jashtme	39
Si krijohen lidhjet e jashtme?	40
Krijimi i lidhjeve nëpërmjet shiritit me vegla.....	41
4. Referimi dhe shënimet.....	42
Ç'janë referimet dhe përse përdoren?	42
Citimi i referimeve	43
Referimi i plotë.....	43
Referimi i shkurtër.....	45
Citimi i përgjithshëm i burimeve	46
5. Fotografitë dhe multimedia	48
Shtimi i fotografisë.....	48
Shtimi i përmbajtjeve të tjera multimediale.....	50
Ngarkimi i përmbajtjeve multimediale	50
6. Tabelat	53
Shtimi i tabelës	53
Simbolet kryesore	54
7. Kategoritë.....	55
Çka paraqesin kategoritë?	55
Shtimi i kategorive	55

Krijimi i kategorisë.....	56
Renditja e përmbajtjes	58
Përdorimi i avancuar	59
Kategoria e fshehur.....	59
Kategoria si link i brendshëm	59
Pema me kategori	59
8. Faqja për bisedë	61
9. Administrimi.....	62
Administratorët	63
Si bëhesh administrator?.....	63
Funksionet e administratorit	65
Burokratët	71
Funksionet e burokratit	72
Keqpërdorimi i funksioneve plotësuese	73
10. Politika	75

Wiki.Mk

Projekti “Pjesëmarrja aktive qytetare nëpërmjet teknologjive të reja”, ka për qëllim ta plotësojë mungesën e informatave me rëndësi lokale – në shumë komuna në Maqedoni, për shembull, burimi i vetëm i informatave janë ueb-faqet e vetëqeverisjes lokale, të cilat rrallë azhurohen. Përveç kësaj, mungojnë ueb-hapësira për komunikim të përbashkët. Duke u nisur nga suksesi i enciklopedisë Wikipedia, si dhe i disa ueb-portaleve lokale (p.sh. Wikimanche), Fondacioni Metamorfozis dëshiron ta promovojë wiki-teknologjinë si zgjidhje të lirë dhe efektive për këto probleme, dhe për këtë arsye e krijoi Wiki.mk, që përfshin vendosje të më shumë ueb-portaleve që janë në dispozicion të drejtpërdrejtë të komuniteteve lokale. Ky projekt realizohet në bashkëpunim me Wikimedia Maqedoni, e cila e ka marrë për obligim realizimin teknik dhe përgatitjet në terren, si dhe bashkëpunimin me organizata të tjera joqeveritare në nivel lokal.

Orientime konkrete redaktuese të wiki-portaleve do të japin organizatat joqeveritare, të cilat do t’i administrojnë projektet në nivel lokal. Në afat të gjatë, projekti wiki.mk ka për qëllim ta ngrisë vetëdijen publike për pjesëmarrje aktive qytetare nëpërmjet teknologjive të reja, duke i përforcuar kapacitetet e organizatave joqeveritare dhe të aktivistëve (individëve dhe grupeve joformale) për përdorimin e tyre, me qëllim që të promovohet wiki-kultura e ndarjes së lirë të njohurive dhe bashkëpunimi i lirë, si dhe rritja e kohezionit të brendshëm të shoqërisë në Maqedoni dhe përshpejtimi i integritetit të saj në BE.

Fondacioni Metamorfozis

Metamorfozis është fondacion i pavarur, jopartiak dhe joprofitabil me seli në Shkup. Qëllimet e tij kryesore janë zhvillimi i demokracisë dhe prosperitetit, duke promovuar ekonomi të bazuar në dije dhe shoqëri informatike.

www.metamorphosis.mk | fb.me/metamorphosis.foundation | twitter.com/fmeta

Wikimedia Maqedoni

Shoqata e qytetarëve Wikimedia Maqedoni, është shoqatë e pavarur, joqeveritare dhe jopartiake e qytetarëve, qëllimi i së cilës është ta përkrahë krijimin, mbledhjen dhe shumëzimin e përmbajtjeve të lira në mënyrë joprofitabile: ta përkrahë idenë që të gjithë njerëzit të kenë qasje të njëjtë te bazat e njohurive dhe te sistemet e arsimit. Misioni kryesor i shoqatës është promovimi i projekteve dhe teknologjive të cilat mundësojnë përhapje të dijes së lirë, siç është enciklopedia e lirë Wikipedia, dhe wiki-teknologjitë, në përgjithësi. Shoqata, zyrtarisht u pranua si degë lokale e Fondacionit Wikimedia në pjesën e dytë të vitit 2009, me miratimin e Këshillit të të besueshmëve të Fondacionit, ndërsa filloi me punë në vitin 2010, kur u regjistrua si subjekt i veçantë juridik.

1

Wiki-teknologjia

Ç'është wiki?

Shumica prej nesh kanë dëgjuar për Wikipedia-n, e bile shpesh edhe e përdorin, mirëpo ndonjëherë është lehtë të harrohet se Wikipedia, si një lloj ueb-faqeje, paraqet vetëm një “wiki”. E po ç'është wiki? Pse ato janë aq të popullarizuara?

Ward Cunningham, njeriu i cili e krijoi wiki-n e parë, e ka përshkruar atë si “baza më e thjeshtë e të dhënave në internet që mund të funksionojë”. Edhe pse kjo duket e lehtë për t'u thënë, nuk është edhe shumë përshkruese, dhe të jemi të sinqertë, as edhe plotësisht precize.

Përshkrimi më i mirë do të ishte: “wiki është sistemi më i thjeshtë bashkëpunues për menaxhim me përmbajtje, që mund të funksionojë”. Kjo nuk tingëllon aq qartë, apo jo? Me gjasë, prandaj edhe Ward Cunningham-i nuk e ka definuar ashtu, mirëpo është një përshkrim më i qartë, sepse e përmend atë që bëri, që wiki-t të përhapen nëpër internet si zjarri në pyll.

Wiki paraqet një sistem për menaxhim me përmbajtje

3Që ta kuptoni një wiki, së pari duhet ta kuptoni idenë prapa **sistemit për menaxhim me përmbajtje**. Sado që të duket e ndërlikuar, sistemi për menaxhim me përmbajtje, në fakt është një koncept shumë i thjeshtë.

Paramendoni se jeni redaktues i një gazete dhe puna Juaj është që ta botoni gazetën për çdo ditë. Nënkuptohe, artikujt e gazetës do të ndryshojnë. Një ditë, do të mbahen zgjedhje lokale, ditën tjetër, ekipi kombëtar është kualifikuar në kampionatin botëror, e ndonjë ditë tjetër, një zjarr i madh e ka shkatërruar një ndërtesë në qendër të qytetit.

Pra, çdo ditë duhet të fusni përmbajtje të reja në gazetë.

Megjithatë, një pjesë e madhe e gazetës mbetet e njëjtë. Për shembull – emri i gazetës. Edhe pse data do të ndryshojë, ajo do të jetë e njëjtë në çdo faqe të atij botimi të gazetës. Bile, edhe formati do të mbetet i njëjtë, me atë që, disa faqe do të kenë tekst në dy kolona, e disa të tjera

në tre kolona.

Tani, paramendoni se e futni emrin e gazetës në çdo faqe, për çdo ditë. Dhe se duhet ta futni datën në të, dhe në mënyrë manuale t'i rregulloni kolonat. Si redaktues, Ju do të keni aq shumë punë, sa që nuk do të keni kohë ta futni përmbajtjen e vlefshme – artikujt – sepse jeni tepër të zënë duke e futur titullin e gazetës, përsëri dhe përsëri.

Në vend të kësaj, blejeni një program kompjuterik që u mundëson të krijoni një shabllon për këtë gazetë. Ky shabllon e shton emrin e gazetës në ballë të çdo faqeje dhe Ju mundëson që ta futni datën njëherë, e pastaj ai e shton në çdo faqe. Do t'i shënojë të gjitha faqet për Ju, e bile edhe do t'i formatojë faqet në dy ose tri kolona, me vetëm një klik.

Ky është një sistem për menaxhim me përmbajtje.

Interneti funksionon në mënyrën e njëjtë. Ndoshta e keni vërejtur se shumica e ueb-faqeve janë të ngjashme me ditarin Tuaj. Emri i ueb-faqes dhe veglat për navigim, mbeten të njëjta, ndërsa përmbajtja ndryshon prej faqes në faqe.

Numri më i madh i ueb-faqeve janë të dizajnuara nëpërmjet sistemit për menaxhim me përmbajtje, i cili i mundëson krijuesit që, në mënyrë të shpejtë dhe të lehtë, të sigurojë përmbajtje për shfrytëzuesin, në mënyrën e njëjtë sikurse redaktuesi që mund të shtojë me shpejtësi artikuj të ri në gazetë, duke mos e dizajnuar në mënyrë manuale çdo detaj të tij.

Sistemi më i thjeshtë për menaxhim me përmbajtje në internet, është blog-u. Thjesht, vetëm e futni atë që dëshironi ta thoni, shtojeni titullin dhe klikoni në butonin “publiko”. Sistemi për menaxhim me përmbajtje do ta shtojë datën në tekst dhe ai do të publikohet në faqen kryesore. Lehtësia e këtij sistemi, me gjasë, është edhe arsyeja për shkak të së cilës blogjet janë aq të popullarizuara.

Ajo që e dallon një wiki nga një blog është fakti se, shumë njerëz mund të punojnë në përmbajtjen e njëjtë. Kjo do të thotë se një artikull mund të ketë së paku një autor, më shumë se dhjetë, e deri në qindra autorë.

Artikujt dallojnë shumë nga blogjet, me atë që artikulli, zakonisht, ka vetëm një autor. Disa blogje paraqesin bashkëpunim të më shumë bloguesve, mirëpo edhe atëherë, për një artikull të veçantë, meritën e merr vetëm një blogues. Ndonjëherë, ndonjëri nga autorët mund të bëjë ndonjë përmirësim, mirëpo zakonisht, jo më shumë se kaq.

Bashkëpunimi është ai që i bën wiki-t aq të suksesshëm.

Paramendoni një lojë shoqërore në të cilën me miqtë jeni të ndarë në dy ekipe dhe përgjigjeni në pyetje kuizi nga tema të ndryshme, ndërsa për përgjigje të saktë merren pikë të caktuara. Të gjithë ne kemi interesa të ndryshme dhe kemi mbledhur dije të caktuar nga këto interese. Bile, mund të ndihemi të sigurt edhe jashtë këtyre interesave, kështu që, edhe nëse nuk jemi profesorë të historisë, megjithatë mund të na kujtohet ndonjë ngjarje dhe datë që e kemi mësuar në shkollë.

Shumicës prej nesh nuk u “flejnë” disa tema. Për shembull, ndoshta e pëlqeni futbollin, mirëpo e urreni basketbollin, kështu që nuk mund të përgjigjeni kush ka shënuar më shumë pikë në ligën NBA në vitin 2009.

Sikur ta luanim kuizin vetë, ekzistojnë kategori për të cilat do të donim të na pyesin dhe ekzistojnë kategori të cilave do t’u shmangeshim.

Mirëpo, kur luajmë në ekip, punët fillojnë të ndryshojnë. Nëse nuk dini shumë për veturat, mirëpo partneri i Juaj di gjithçka që mund të dihet për to, atëherë ndiheni të sigurt gjatë përgjigjes në ndonjë pyetje për automobila. E kemi mbledhur dijen tonë të përbashkët dhe prandaj jemi të përgatitur më mirë për t’u përgjigjur në pyetje të ndryshme.

Wiki është bashkëpunim për përmbajtje

TKjo është ajo që i shtyn përpara ueb-faqet: e mbledh dijen e një grupi të caktuar të njerëzve, për ta krijuar resursin më të mirë të mundshëm. Prandaj, artikulli bëhet bashkësi e dijes së njerëzve që kanë punuar në një artikull. Njëlloj si te kuizi në të cilin jemi më të mirë si ekip, artikulli bëhet më i mirë kur krijohet nga ndonjë ekip. Anëtarët e ndryshëm të ekipit kontribuojnë në mënyra të ndryshme.

Mendoni për doracakun që jeni duke e lexuar. Ne kemi mjaft njohuri për wiki-t dhe dhe jemi të aftë t’i sqarojmë bazat e tyre. Mirëpo, çka sikur ta kishin Ward Cunningham-in, krijuesin e wiki-t të parë, të vinte dhe të kontribuonte për këtë doracak? Ai është një ekspert shumë më i madh për këtë temë dhe mund të futet në detaje për disa fusha. Më tutje, çka nëse Jimmy Wales, themeluesi i Wikipedia-s, na ndihmonte gjatë shkrimit të doracakut? Përsëri do të kishim më shumë detaje. Mirëpo, edhe pse Cunningham dhe Wales kanë pasuri njohurish për wiki-t, ndoshta ata nuk janë shkruar të mirë. E ç’do të ndodhte sikur të vinte redaktuesi i ndonjë gazete të madhe ta “tëharrë” dhe ta rregullojë tekstin?

Rezultati përfundimtar – Ju do të lexonit një doracak shumë më të mirë.

Këtu qëndron bukuria e wiki-ve! Ato mundësojnë që më shumë njerëz të punojnë në dokumentin e njëjtë. Nëpërmjet punës së përbashkët jemi të aftë të krijojmë një resurs, që është superior ndaj çdo gjëje tjetër që do ta krijojmë vetë.

Përfundim

Akoma jeni të hutuar? E sqaruam konceptin e wiki-t dhe pse wiki-t u bënë një vegël aq e vlefshme, mirëpo nuk sqaruam se çka saktë është wiki.

E po ç'është?

Është një libër. Dhe zakonisht, është libër me informata si në një fjalor ose enciklopedi. Pasiqë është në formë të rrjetit dhe gjendet në internet, shfrytëzoni shfletues në vend të përmbajtjes me numrat e faqeve të librit. Pastaj, nga çdo artikull i veçantë, mund t'u qaseni disa temave të reja. Për shembull, në artikullin për “wiki” në Wikipedia, ka link për te artikulli për Ward Cunningham-in. Kështu, në vend që t'i rrotulloni fletët në libër që ta kuptoni tregimin e plotë, mundeni vetëm t'i ndiqni linket.

Ç'mund të bëjnë wiki-t për Ju

Tani pasi e dijmë se ç'është wiki, shtrohet pyetja pse do ta përdorte dikush atë? Cilat janë përfitimet?

Përfitimi më i madh dhe më i dukshëm është ai se wiki-t janë burim i shkëlqyeshëm për informata pa pagesë. Edhe pse, jo çdo wiki është i lirë për shfrytëzim, ato që gjenden në internet nuk kërkojnë t'u paguhet për leximin e përmbajtjes së tyre. Për shkak të punës së përbashkët të shumë njerëzve të ndryshëm, ato shpesh përmbajnë shumë informata të mira. Në shumë mënyra, popullarizimi i wiki-t e shndërroi internetin në bibliotekë të dijes, që është e lehtë për shfrytëzim.

Wiki-temat ndryshojnë nga njohuritë e përgjithshme, si Wikipedia (wikipedia.org), deri te tema shumë më specifike si RecipesWiki (recipes.wikia.com) për gatim, ose FitnessWiki (fitness.wikia.com) për fitnes.

2

Redaktimi

Një wiki-komuniteti të fuqishëm i duhen lexues dhe redaktues. Lexuesit dhe redaktuesit ndikojnë mbi njëri-tjetrin. Një wiki-je i duhet përmbajtje që të tërheqë lexues, e me ata lexues do të vijnë edhe ata që dëshirojnë të kontribuojnë në përmbajtje. Këta lexues që janë bërë redaktues, krijojnë përmbajtje të re, që tërheq lexues të ri, prej të cilëve, disa do të bëhen redaktues dhe në këtë mënyrë, wiki hyn në rrethin magjik të suksesit.

Çdokush mund të kontribuojë për një wiki. Të gjithë ne dijmë diçka, ndërsa disa prej nesh dijmë shumë për disa gjëra, ndonjë tjetër di shumë për disa gjëra të tjera. Wiki-t e shfrytëzojnë këtë dije për të krijuar një burim të madh informatash për secilin.

Edhe pse shumë njerëz mund të kontribuojnë me dije, nuk mund të gjithë ta bëjnë atë duke përdorur gjuhë të mirë dhe të saktë. Prandaj, disa redaktues bëjnë korrigjime drejtshkrimore dhe gramatikore dhe kujdesen që teksti të jetë i shkruar mirë dhe i lehtë për t'u lexuar. Redaktues të tjerë mund të ndihmojnë me rregullim dhe përmirësim të formatimit, shtim të ilustrimeve në tekst dhe kontribute të tjera të vlefshme.

Në këtë pjesë të doracakut do të njiheni me bazat e redaktimit të një wiki-faqeje.

Dritarja për lexim

Nëse hapni një wiki-faqe, do të vëreni se në ballë të saj gjenden disa tab-e (fletëza me opzione) (Fotografia 2.1). Ato janë ndarë në dy grupe, nga i cili, i pari ka të bëjë me llojin e qëllimit të faqes (në të majtë të fotografisë), ndërsa i dyti ka të bëjë me disa veti të faqes (në të djathtë të fotografisë).

Duhet theksuar se tab-et për llojin e qëllimit të faqes janë të dy llojeve, që paraqesin faqe të veçanta, ndërsa tab-et për vetitë paraqiten në tri lloje dhe kanë të bëjnë me secilën nga faqet e përmendura më parë veç e veç. Në këtë mënyrë paraqiten gjithsej gjashtë faqe të vetive.

Gjatë hapjes së cilësdo faqe është i përzgjedhur tab-i "Faqja", që thjesht tregon se është e hapur ndonjë faqe, e poashtu është i përzgjedhur edhe tab-i "Lexo", i cili, siç tregon edhe vetë emri, tregon se përmbajtja e faqes mund të lexohet.

Artikulli

Diskutimet

Lexoni

Redakto

Shiko his

Fotografia 2.1. Tab-et në ballë të një wiki-faqeje.
Të ndritshme janë tab-et “Faqja” dhe “Lexo”

Tab-et tjera nuk janë të përzgjedhura dhe për to më detajisht do të bëhet fjalë në vazhdim.

1. Redaktimi Juaj i parë

Nëse e shtypni tab-in ”Redakto”, atëherë do të hapet një dritare për redaktim ku mund ta ndryshoni përmbajtjen e faqes.


The screenshot shows the Wikipedia edit interface for the article "Ohri". At the top, there are navigation tabs: "Artikulli", "Diskutimet", "Lexoni", "Redakto", and "Shiko historikun". Below the tabs, the title "Duke redaktuar Ohri" is displayed, followed by "Nga Wikipedia, Enciklopedia e Lirë". The main editing area contains a rich text editor with various icons for text formatting, alignment, and insertion. The text being edited is: `{{KUTIAOhri}}`
[[Skeda:Ohrid-Old-Town.JPG|thumb|right|270px|Qyteti i vjetër]]
'''Ohri''', (pa shq. ''Ohër'', [[Gjuha Maqedone|maqedonisht]]: Охрид), është pjesën jug-perendimore të [[Maqedoni|Maqedonisë]] pranë liqenit me të njëj rreth 50 000 banorë.

Fotografia 2.2. Dritarja për redaktim të faqes “Kubi i Rubikonit” në Wikipedia. Shihet përmbajtja e artikullit, e shënuar me wiki-kod, në formë që mund të redaktohet. A e vëreni se teksti që mund të ndryshohet përmban disa shenja të caktuara (thonjëza dhe kllapa të mesme: “”Kubi i Rubikonit”” është një [[enigmë]] mekanike)? Ky është një wiki-formatim, një kod që mundëson që teksti të paraqitet në një mënyrë të caktuar (rezultati nga shembulli paraprak është: „Kubi i Rubikonit është një enigmë mekanike ” (fjala “enigmë” paraqet link që çon te faqja me titull “Enigmë” në wiki). Wiki-formatimi do të sqarohet në vazhdim.

Përpiquni që të vini deri te dritarja për redaktim të ndonjë wiki-faqeje dhe ndryshojeni përmbajtjen ashtu siç do ta ndryshonit në cilindo goftë redaktues për tekst.

Pasqyra e ndryshimeve

Pasi t'i bëni ndryshimet në tekst, në pjesën e poshtme të dritares për redaktim gjenden këto butone dhe fusha:



Përmbledhje:

Ky është një redaktim i vogël Mbikëqyre këtë faqe

[Harroji | Ndhmë për redaktim \(hapet në një dritare të re\)](#)

Fotografia 2.3. Pjesa e poshtme e dritares për redaktim. Shënohet fusha për përshkrimin e ndryshimeve dhe butonat Ruaj, Pasqyra dhe Paraqiti ndryshimet.

- Me shtypje të butonit "Pasqyra", paraqitet faqja ashtu si do të dukej nën tab-in "Lexo", me ndryshimet që i keni bërë. Rekomandohet që gjithmonë t'i shihni ndryshimet që i keni bërë, që të jeni të sigurt se do ta fitoni rezultatin që e dëshironi;
- Mund të zgjedhni ta shtypni butonin "Paraqiti ndryshimet", me ç'rast qartë shënohen ndryshimet në kod, duke e krahasuar versionin e vjetër me versionin që e keni redaktuar.



Duke redaktuar Hëna

Nga Wikipedia, Enciklopedia e Lirë

Parapamje

Kini kujdes se kjo është vetëm një parapamje, nuk është ruajtur akoma!

Hëna është sateliti i vetëm natyror i tokës.

A A



► Avancuar

► Karaktere të veçanta

► Ndhimë

```
'''Hëna''' është sateliti i vetëm natyror i [[tokë]]s.
```

Fotografia 2.4. Kështu duket dritarja kur do ta shtypni butonin “Pasqyra”.

Pjesa e poshtme e dritares e përmban shiritin me vegla për redaktim dhe kutinë për tekst, në të cilën e ndryshoni tekstin nëpërmjet wiki-kodit. Krahasojeni me gjysmën e epërme, e cila tregon se si do të paraqitet ai wiki-kod.

Përshkrimi i ndryshimeve

Është shumë me rëndësi që të jepet përshkrim i shkurtër i ndryshimeve që i keni bërë, ashtu që redaktuesit që i ndjekin ndryshimet e fundit ose që e shohin historinë e ndryshimeve të faqes, ta dijnë se çka paraqet redaktimi Juaj. Kjo bëhet duke futur tekst në fushën “Përshkrim”.

Përmbledhje:

Fotografia 2.5. Futja e përshkrimit të shkurtër të ndryshimeve.


Ruajtja e faqes

Pasi të jeni të kënaqur me ndryshimet që i keni bërë dhe pasi ta keni bërë përshkrimin e shkurtër të atyre ndryshimeve, shtypeni butonin “Ruaj” (Fotografia 2.3 ose Fotografia 2.5.).

Rezultatet e redaktimit Tuaj do t’i vëreni menjëherë në përmbajtjen e tab-it “Lexo”!

Shënimi i ndryshimit të vogël

Nën butonat për ruajtje, pasqyrë dhe paraqitje të ndryshimeve, gjendet kutiza për përzgjedhje, me titull “Ky është ndryshim i vogël” (Fotografia 2.6.).



Опис (Накратко опишете ги промените што ги направивте)

правописни поправки

Ова е ситна промена (што е ова?) Набљудувај ја оваа страница

Зачувај Преглед Прикажи промени Откажи | Помош за уредување

Fotografia 2.6. Kutiza për përzgjedhje të ndryshimit të vogël

Duke e përzgjedhur kutizën “ky është ndryshim i vogël”, tregoni se keni bërë vetëm ndryshime sipërfaqësore ndërmjet versionit të ri dhe atij të vjetër të faqes, si për shembull:

- Përmirësimi i gabimeve drejtshkrimore;
- Formatimi, pamja e ndryshme e artikullit;
- Zhvendosja e pjesëve të tekstit, pa mos e ndryshuar përmbajtjen dhe të ngjashme.

Thjesht, ndryshimi i vogël është ai për të cilin redaktuesi konsideron se nuk duhet të kontrollohet, dhe se asnjëherë nuk mund të kontestohet.

Përkundër kësaj, ndryshimi më i madh është version i cili duhet të shqyrtohet, të konfirmohet se me të pajtohen të gjithë redaktuesit e interesuar. Kështu, cilido qoftë ndryshim që e ndryshon domethënien e artikullit, nuk është i vogël, qoftë nëse kemi ndryshuar edhe vetëm një fjalë të vetme.

Dallimi në mes të ndryshimeve të vogla dhe të mëdha është i rëndësishëm, sepse bashkëpunëtorët mund t’u mos u kushtojnë vëmendje ndryshimeve që janë shënuar si të vogla, gjatë shi-

kimit të ndryshimeve të fundit; shfrytëzuesit e regjistruar mund t’i bëjnë përshtatjet e tyre në atë mënyrë që ato nuk do të paraqiten aspak. Nëse mendoni se ka edhe gjasë më të vogël që ndonjë redaktues t’i kontestojë ndryshimet e Juaja, Ju lutemi, mos i shënoni ato si të vogla.

Bashkëpunëtorët që nuk janë të regjistruar dhe të lajmëruar, nuk mund t’i shënojnë ndryshimet e vogla, me qëllim që të pengohet vandalizmi i mundshëm. Mundësia për shënim të ndryshimeve të vogla është edhe një arsye për regjistrim.

Cilat ndryshime duhet t’i shënoni si të vogla

- Përmirësime në drejtshkrim;
- Formatimi i thjeshtë (shkronja të mëdha, presje, kllapa, gramatikë themelore e të ngjashme);
- Formatimi që nuk e ndryshon domethënien e artikullit (për shembull shtimi i rreshtave, ndarja e pjesëve të tekstit);
- Gabime të qarta faktografike (për shembull ndryshimi i vitit nga 1873 në 1973, kur është e qartë se ngjarja ka ndodhur në shekullin XX);
- Përmirësime të gabimeve në pamje;
- Shtimi dhe zhvendosja e wiki-linkeve;
- Fshirja e vandalizimit.

Çka duhet të mbajmë në mend


- Cilido qoftë ndryshim në tekstin burimor, edhe atëherë kur nuk ndikon në pamjen e faqes në HTML (p.sh. shtimi i një vendi të zbrazët, kalimi në rresht të ri), do të shtohet si ndryshim në bazën e të dhënave;
- Shënimi i ndryshimit më të madh si ndryshim i vogël konsiderohet sjellje e keqe, veçanërisht nëse ndryshimi është fshirje e një pjese të tekstit;
- Heqja e ndryshimeve, në pjesën më të madhe të rasteve, nuk mund të konsiderohet si ndryshim i vogël.
- Kur statusi i faqes është i kontestuar, më mirë është që asnjë ndryshim të mos shënohet si i vogël, me përjashtim të vandalizmit të qartë.

Nëse rastësisht e shënoni ndonjë ndryshim si të vogël, bëjeni edhe një ndryshim, p.sh. shtoni një vend të zbrazët në mes të dy fjalëve (disa lloje të ndryshimeve, siç është shtimi i rreshtit të zbrazët në fund të artikullit, automatikisht nuk merren parasysh), e pastaj te përshkrimi shënoni se ndryshimi paraprak ka qenë i madh

Paraqitja e ndryshimeve

OPasi të bëni ndryshime në dritaren për redaktim, para se ta ruani faqen, mund të bëni paraqitje të ndryshimeve ndërmjet revizionit aktual dhe tekstit Tuaj të ndryshuar, duke e shtypur butonin “Paraqiti ndryshimet” (gjendet në rreshtin e njëjtë me “Ruaj” dhe “Pasqyra” në fotografinë 2.3).

Dritarja për paraqitje të ndryshimeve i shënon pjesët dhe fjalët në të cilat ka ndryshime, duke e krahasuar versionin e vjetër dhe atë të ri, njërin pranë tjetrit (Fotografia 2.7.).



Fotografia 2.7. Kështu duket dritarja për paraqitje të ndryshimeve.

Në anën e majtë është paraqitur teksti i vjetër, ndërsa në anën e djathtë teksti i ri.

Paragrafet në të cilat ka ndryshime janë të shënuara me

të verdhë (në të majtë) dhe me të gjelbër (në të djathtë), kurse fjalët e ndryshuara shënohen me të kuqe.

Vëreni se poshtë vazhdon dritarja për redaktim, kështu që menjëherë mundeni të vazhdoni të bëni ndryshime.

Me këtë paraqitje mund t'i ikni ruajtjes së ndryshimeve të padëshiruara, të cilat i keni bërë pa qëllim.

2. Historia e redaktimeve

Deri tani u sqaruan dy nga tre tab-et e vetive të faqes, kurse i pasqaruar mbeti edhe tab-i "Shih historinë", që është i fundit në grupin e tabe-ve të vetive të faqes (Fotografia 2.1.). Me shtypjen e këtij tab-i, hapet një dritare e re me listë të të gjitha redaktimeve që janë bërë në këtë faqe. Ashtu siç tab-i "Redakto" mundëson futje dhe ndryshim të përmbajtjes së faqes, që mund të lexohet duke e shtypur tab-in "Lexo", ashtu edhe tab-i "Shih historinë" mundëson që të kuptohet se kush, kur dhe çka ka ndryshuar në përmbajtjen e faqes. Kjo është shumë me rëndësi për vetë shfrytëzuesit, mundi i të cilëve mbetet i vulosur dhe çdokush mund ta shohë, mirëpo edhe për tërë komunitetin, sepse e lehtëson pasqyrën e ndryshimeve që janë bërë në faqe dhe e lehtëson pengimin e vandalizmit.



Formatimi i tekstit

Formatimi i tekstit bëhet nëpërmjet pështatjeve përkatëse, të cilat mund të bëhen nëpërmjet shiritit me vegla për redaktim, mirëpo edhe duke futur simbole nga dritarja për redaktim. Në vazhdim janë paraqitur të dyja mënyrat.

Shkronjat e trasha dhe kurzive (të pjerrëta)

- Shkronjat e trasha – fonti i trashur (bolld) fitohet, ashtu që teksti i pëlqyer futet ndërmjet gjashtë simboleve për apostrofë (tri nga njëra dhe tri nga ana tjetër e tekstit), "ja kështu".
- Shkronjat kurzive (të pjerrëta) – fonti kurziv (italik) fitohet ashtu që teksti i pëlqyer vendoset ndërmjet katër simboleve për apostrofë (dy nga njëra dhe dy nga ana tjetër e tekstit), "ja kështu".

Trashja dhe pjerrësimi (bërja kurziv) nëpërmjet shiritit me vegla për redaktim

Në pjesën e epërme të dritares për redaktim gjendet shiriti me vegla (Fotografia 2.8.), i cili përmban butona të ngjashme me butonat standardë të një redaktuesi për tekst të llojit të Microsoft Word ose OpenOffice. Variant më i lehtë është ta përzgjidhni tekstin që dëshironi ta trashni/ta pjerrësoni dhe të klikoni në  për trashje ose  për pjerrësim.

Што внесувате	Што добивате
''закосено''	закосено
'''задебелено'''	задебелено
''''''закосено и задебелено''''''	закосено и задебелено

Fotografia 2.8. Dritarja për redaktim së bashku me shirtin për vegla për redaktim. Me të kuqe janë shënuar butonat për trashje dhe pjerrësim.

Ku përdoret më shpesh teksti i trashur dhe i pjerrët

- Wiki-t informative, shembull më i mirë i të cilëve është Wikipedia, artikujt për tema të veçanta, gjithmonë i fillojnë me emrin e faqes, të shkruar me shkronja të trasha, e pastaj vijon definicioni i shkurtër për termin për të cilin bëhet fjalë.

Për shembull, artikulli për Albert Ajnshtajnin fillon kështu:

Albert Ajnshtajni (Ulm, 14 mars 1879 – Princeton, 18 prill 1955) ka qenë teoricien i fizikës nga Gjermania, më së shumti i njohur për teorinë e tij të relativitetit dhe teorinë për ekuivalencën e masës dhe të energjisë, $E = mc^2$...

- Me shkronja kurzive shënohen fjalët që nuk janë shkruar në gjuhën në të cilën është i shkruar teksti. Gjithashtu, shfrytëzohen kur ndonjë fjalë ose frazë duhet të theksohet në mënyrë të qartë që të dallohet:

...po atë vit filmi “Shkoi bashkë me erën” (anglisht: Gone With The Wind) është nominuar për Oskar...

...puna automatike e zemrës është aftësia që të kontraktohet në ndikimin e impulsit që krijohet në nyjen sinusale, i cili për këtë arsye quhet edhe pararojë e punës së zemrës.

Shtimi i titujve dhe nëntitujve

Pjesët e veçanta të një teksti janë mënyrë e mirë për t’u përmirësuar organizimi i një faqeje, sepse krijojnë strukturë që paraqitet në tabelën me përmbajtjen. Nëse vëreni ndonjë përmba-

jtje për dy tema të ndryshme në një artikull (për shembull, një tekst që e përshkruan gjeografi- në dhe një tekst që e përshkruan historinë e një vendi), mund t'i ndani në pjesë, të cilat pastaj mund t'i ndani në mënyrë kierarkike në tituj, nëntituj, stërnëntituj e kështu me radhë. Në çdo faqe me së paku katër pjesë përbërëse, automatikisht krijohet tabelë me përmbajtje, e cila gjendet menjëherë pas hyrjes në artikull (Fotografia 2.9.).

Страница **Разговор** Читај **Уреди** Види истори

Битола

Од Википедија, слободната енциклопедија

Битола е град во југозападниот дел на Македонија. Битола е административен, културен, економски, индустриски, образовен и научен центар за тој дел од Македонија. Градот е познат под името *град на конзулите* бидејќи тука се наоѓаат дел од конзуларните претставништва во Република Македонија. Битола е трет по големина град во Македонија според бројот на жители, додека по површина е втор. За време на Југославија бил еден од културните центри, како во Кралството Југославија, така и во СФР Југославија. Таткото на турската нација Кемал Ататурк завршил офицерска школа во Битола. Некои негови работи денес се чуваат во битолскиот Народен музеј.

Содржина [сокриј]

- 1 Етимологија
- 2 Историја
 - 2.1 Праисторија
 - 2.2 Римски период
 - 2.3 Балкански војни
 - 2.4 Евреите во Битола
- 3 Географија
 - 3.1 Клима
 - 3.2 Демографија
 - 3.2.1 Религиозни групи
- 4 Битола како град на конзулите
 - 4.1 Времето на конзулите
 - 4.2 Денешни конзуларни претставништва
 - 4.2.1 Генерални конзулати
 - 4.2.2 Почесни конзулати

Fotografia 2.9. Faqja për Manastirin në Wikipedia.

Нë gjysmën e poshtme të fotografisë shihet tabela me përmbajtje, në të cilën është paraqitur se si teksti është i ndarë nëpërmjet pjesëve në tituj, nëntituj dhe stërnëntituj.

- Titujt e pjesëve fitohen duke e futur `==titullin e dëshiruar==` ndërmjet dy simboleve për barazim (dy nga njëra anë dhe dy nga ana tjetër), gjë që duhet bërë në fillim të rreshtit.
- Nëntitujt dhe stërnëntitujt përkatës fitohen me `===tri===` ose me `====katër====` simbole për barazim.
- Pjesët janë të renditura në mënyrë hierarkike. Vetë titulli shfrytëzon titull të rendit të parë (`=Titulli i faqes=`), prandaj përmbajtja e mbetur e faqes fillon të organizohet me titull të rendit të dytë (`==Titulli==`) dhe vazhdon më tej me nivele më të ulta: `===Nëntitulli===`, `====Stërnëntitulli====` etj.

Што внесувате	Што добивате	
<code>== Наслов ==</code>	Наслов	[уреди]
<code>=== Поднаслов ===</code>	Поднаслов	[уреди]
<code>==== Поднаслов на поднасловот ====</code>	Поднаслов на поднасловот	[уреди]

Битола како град на конзулите [уреди]

Градот на конзулите е второто име за градот Битола. Во врвот на својата слава, Битола има слабеенето на државата, со доаѓањето на династијата Караѓорѓевиќ на власт, а подоцна и само неколку конзулати. Со независноста на Македонија, државата економски се засилила, слава. Повторно почнуваат да се отвораат конзулати и градот го добива својот некогашен сј

Времето на конзулите [уреди]

За време на Отоманската Империја, градот имал многу конзули од сите значајни земји, па Е 26 јули 1903, на влезот во градот бил погубен рускиот конзул Александар Аркадјевич Ростк и раја, која Турците ја угнетувале. На местото на погубувањето денес стои голем руски крст.

Денешни конзуларни претставништва [уреди]

Моментално градот Битола има единаесет конзуларни претставништва од кои два генерални


Генерални конзулати [уреди]

-  Бугарија
-  Грција

Фотографија 2.10. Нјe pjesë e tekstit për Manastirin në Wikipedia. Shihni se si përmbajtja është e ndarë në më shumë pjesë, të cilat janë të ndara në mënyrë hierarkike, nëpërmjet titullit të rendit të dytë (`==Manastiri si qytet i konzulje==`), nëntitujve të rendit të tretë (`===Përfaqësitë e tashme konzullare===`) dhe stërnëntitullit të rendit të katërt (`====Konzullatet e përgjithshme====`). Gjithashtu, kushtoni vëmendje linkut [redakto] që gjendet pranë titullit të çdo pjesë. Me shtypjen e këtij linku hapet një dritare për redaktim, vetëm për pjesën adekuate (që është sqaruar më poshtë).

Shtimi i pjesës së re nëpërmjet shiritit me vegla për redaktim

Pjesë të re, me titull të nivelit të dytë deri në nivelin e pestë, mund të shtoni edhe nëpërmjet shiritit me vegla për redaktim. Për këtë qëllim, më parë duhet ta zgjedhni veglën “E avancuar”, e cila ofron vegla plotësuese, e pastaj, në anën e majtë ta zgjedhni nivelin që e dëshironi për titullin (Fotografia 2.11.). Për shembull, nëse shtypni në “Niveli 2“, në kutinë për tekst do të fitoni == Titulli ==.



Fotografia 2.11. Shtimi i një pjese nëpërmjet shiritit me vegla për redaktim.

Tabela me përmbajtje

Tabela me përmbajtje (e paraqitur në pjesën e poshtme të Fotografisë 2.9.) i paraqet në mënyrë hierarkike të gjitha pjesët e tekstit, të paraqitura si linke, për qasje më të shpejtë deri te përmbajtja e tyre. Tabela krijohet automatikisht, nëse në faqe ekzistojnë së paku katër pjesë. Wikikodi me të cilin mund të përshtatet paraqitja dhe pozita e tabelës, është dhënë në vazhdim.

Mund të pengohet paraqitja automatike e tabelës me përmbajtje nëse:


- (për shfrytëzuesit) në përshtatjet është zgjedhur që ajo të jetë e fshehur;
- (për një faqe) në faqe është shtuar kodi `__NOTOC__`.

Pjesët e veçanta mund të redaktohen veç e veç

KKur do ta shtypni tab-in “Redakto”, do të hapet një dritare, në të cilën mund ta redaktoni përmbajtjen e tërë faqes. Mirëpo, çka nëse duhet të bëni ndryshime vetëm në një pjesë të tekstit? Pjesët e veçanta të një teksti mund të redaktohen veç e veç, duke i shtypur linket e veçanta për redaktim, të shënuara si [\[redakto\]](#), menjëherë pranë titullit të pjesës (Fotografia 2.10.).

Kjo është e dobishme nëse redaktimi nuk përfshin pjesë të tjera dhe nëse redaktuesi, gjatë redaktimit nuk ka nevojë për tekstin para tij.

Redaktimi i pjesëve është posaçërisht i dobishëm gjatë redaktimit të faqeve të mëdha: kështu, hapja e dritares për redaktimin e tyre mund të zgjasë më tepër dhe shfletuesi mund të punojë më ngadalë.




Shtimi i shënimit `__NOEDITSECTION__`, kudo që të jetë në faqe, mund t'i largojë linket e veçanta për redaktimin e pjesëve.


Që të shtohet një pjesë e re, në fund të pjesës paraprake duhet të shtohet titulli i ri. Me heqjen e titullit të pjesës konkrete, përmbajtja e tij ngjitet me përmbajtjen e pjesës paraprake.

Shtimi i një pjesë të re në fund të faqes

Në faqet për bisedë (të cilat janë të sqaruara më poshtë), dhe në faqet të cilat në wiki-kodin e përmbajnë shënimin `__NEWSECTIONLINK__`, ekziston një tab i veçantë, që quhet "Shto temë" ose "+" në ballë të faqes (Fotografia 2.13.). Duke e shtypur atë, shtohet një pjesë e re në fund të faqes



Kur do të klikoni në këtë tab, hapet një dritare për redaktim, dhe ajo përmban një kuti në të cilën shkruhet titulli i pasusit të ri dhe një kuti për tekstin e pasusit (Fotografia 2.14.). Gjithashtu, nuk ka kuti për përshkrim të ndryshimeve, sepse ai përshkrim krijohet në mënyrë automatische.



Mënyra e lehtë për krijimin e pjesëve të reja është shumë e dobishme për faqet për bisedë, për shkak se mundësojnë mënyrë të shpejtë dhe të lehtë për të filluar diskutim të ri.

Shtimi i vijës horizontale

Tekstin mund ta ndani me vijë horizontale që krijohet duke shtuar katër viza (----) në fillim të rreshtit të ri.

Për shembull, futni:

```
Ky tekst është lart...
```

```
----
```

```
...kjo është poshtë.
```

Me ç'rast fitohet:

```
Ky tekst është lart...
```

```
...kjo është poshtë.
```

Teksti që është i ndarë në këtë mënyrë nuk ndikon mbi strukturën e pjesëve dhe nuk paraqitet në ndonjë mënyrë, në tabelën me përmbajtje.

Shkruarja e tekstit në rresht të ri

Nëse e shtypni njëherë butonin Enter kur futni tekst në dritaren për redaktim, teksti që do ta shkruani në mënyrë plotësuese në kutinë për tekst, do të kalojë në rresht të ri, mirëpo kur do ta ruani faqen, të dy rreshtat do të bashkohen. Për shembull:

```
fjalìa 1
```

```
fjalìa 2
```

do to paraqitet si:

```
fjalìa 1 fjalìa 2
```

Mënyra e vetme për të kaluar në rresht të ri është duke krijuar ndarje të re (d.t.th. shtypni dy herë butonin Enter). Kështu:

fjalja 1
(rresht i zbrazët)
fjalja 2

do të paraqitet si:

fjalja 1

fjalja 2

Mirëpo, nëse doni të kaloni në rresht të ri, pa krijuar ndarje të re, mund ta shfrytëzoni shenjën `
`. Për shembull:

```
fjalja 1 <br /> fjalja 2
```


ose:

```
fjalja 1 <br />  
fjalja 2
```

paraqitet si:

fjalja 1
fjalja 2

Rreshti i ri nëpërmjet shiritit me vegla për redaktim



Tërheqja e rreshtave në të djathtë

Wiki-teksti mund të tërhiqet në të djathtë duke i shtuar dy pika (:) në fillim të rreshtit. Më shumë simbole për dy pika, e zhvendosin tekstin më tepër. Për shembull:


```
fjalìa e parë  
:fjalìa e dytë  
::fjalìa e tretë  
:::fjalìa e katërt  
fjalìa e pestë
```

do ta paraqitet si:

```
fjalìa e parë  
  fjalìa e dytë  
    fjalìa e tretë  
      fjalìa e katërt  
fjalìa e pestë
```

Kjo më shpesh shfrytëzohet në faqet për bisedë, për të dhënë përgjigje ndaj mendimit të dikujt.

Tërheqja e tekstit nëpërmjet shiritit me vegla për redaktim



Ndarja e një blloku me tekst

Shtimi i dy pikave e tërheq tekstin vetëm nga ana e majtë në të djathtë. Nëse ka nevojë që një tekst i caktuar të tërhiqet nga të dyja anët (edhe nga e majta edhe nga e djathta), atë e ndajmë me shenjat `<blockquote></blockquote>`, me ç'rast, teksti i ndarë duhet të shkruhet ndërmjet dy shenjave. Për shembull:

Tërpe Tërpkovski veprën e përshkroi me këto fjalë:
`<blockquote>`“Deri tani, unë nuk kam parë pikturë më të shëmtuar. Konsideroj se arti në këtë qytet është seriozisht i kërcënuar nga mungesa e kualitetit. Z. Stojkovski nuk meriton të ketë vepra të ekspozuara në galerinë e qytetit.”`</blockquote>`
Tërpkovski këtë deklaratë e dha në fillim të shtatorit.

do të paraqitet si:

Tërpe Tërpkovski veprën e përshkroi me këto fjalë:
“Deri tani unë nuk kam parë pikturë më të shëmtuar. Konsideroj se arti në këtë qytet është seriozisht i kërcënuar nga mungesa e kualitetit. Z. Stojkovski nuk meriton të ketë vepra të ekspozuara në galerinë e qytetit.”
Tërpkovski këtë deklaratë e dha në fillim të shtatorit.

Kjo mënyrë e ndarjes së blloqeve të tëra me tekst, shpesh gjen zbatim gjatë paraqitjes së citateve.

Krijimi i listave

Në një tekst, shpesh ka nevojë për listë me numra. Kjo bëhet me ndihmën e listave. Ekzistojnë tri lloje të listave: listë me numra rendorë (listë e renditur), listë me nënpika (lista jo të renditura) dhe listë për definicione. Në vazhdim është sqaruar dallimi në mes tyre.

Listë me numra rendorë

1. Ky është një shembull
2. për listë të renditur
3. që ka numra rendorë

Listë me nënpika

- Kështu duket
- lista jo e renditur
- gjegjësisht lista me nënpika

Listë me definicione

Termi 1

Listat për definicione janë të këtilla.

Termi 2

Ato janë të dobishme për renditjen e termeve me sqarime për to.

Në tabelën në vazhdim është paraqitur përdorimi i shenjave të ndryshme, me të cilat fitohen renditje të ndryshme.

Çka futet	Çka fitohet
<p>''Listat me nënpika'' bëhen lehtë: ** çdo rresht të ri fillojeni * me yll ** më shumë yje do të japin *** nivel më të thellë</p>	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Listat me nënpika'' bëhen lehtë:</i> <ul style="list-style-type: none"> • çdo rresht të ri fillojeni • me yll • më shumë yje do të japin • nivel më të thellë
<p>*Rreshti i ri *në një listë</p> <p>e shënon fundin e listës. Gjithsesi,</p> <p>*mund të filloni *prej fillimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Rreshti i ri • në një listë <p>e shënon fundin e listës. Gjithsesi,</p> <ul style="list-style-type: none"> • mund të filloni • prej fillimit.
<p>#Listat me numra rendorë janë të mira ##janë shumë të organizuara ##janë të lehta për t'u përcjellë</p>	<p>1.Listat me numra rendorë janë të mira</p> <p>1.janë shumë të organizuara 2.janë të lehta për t'u përcjellë</p>
<p>;Listat për definicione ;Termi : definicioni ;pikëpresje, pastaj termi :dy pika, pastaj definicioni</p>	<p>Listat për definicione Termi definicioni pikëpresje, pastaj termi dy pika, pastaj definicioni</p>
<p>*Mund të krijoni edhe lista të përziera *# dhe t'i dhëmbëzoni ** në këtë mënyrë **; definicionet **: funksionojnë edhe këtu: **; molla dhe **; banania #: janë pemë # kjo është relativisht e thjeshtë</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Mund të krijoni edhe lista të përziera <ol style="list-style-type: none"> 1. dhe t'i dhëmbëzoni <ul style="list-style-type: none"> • në këtë mënyrë <p>definicionet funksionojnë edhe këtu: molla dhe banania janë pemë</p> 2. kjo është relativisht • e thjeshtë

Vini re se nëse dëshironi të futni tekst në rresht të ri, në mes të listës me numra rendorë, kalimi i zakonshëm në rresht të ri do ta ndërpresë listën.

Që të shtoni diçka në kontekst të listës, dhe kjo të mos jetë me numër rendor (për shembull, ndonjë koment), para asaj që do ta shtoni, futni tarabë (#) dhe dy pika.

Pastaj vazhdoni me listën. Për shembull, nëse e futni kodin:

```
#numërojmë
ndërpresim
#dëshirojmë të vazhdojmë
#me listën e parë
```

do të paraqitet:

1. numërojmë
ndërpresim
1. dëshirojmë të vazhdojmë
2. me listën e parë

Pas ndërprerjes, në rreshtin e ardhshëm lista vazhdon prej fillimit (1.). Kjo nuk është e pëlqyeshme dhe mund t'i shmangemi me tarabë dhe dy pika:

```
#numërojmë
#:ndërpresim me tarabë dhe dy pika
#vazhdojmë
#me listën e parë
```

me ç'rast fitohet:

1. numërojmë
ndërpresim me tarabë dhe dy pika
2. vazhdojmë
3. me listën e parë

Këtë mund ta bëni edhe me listat me nënpika:


```
*niveli i parë
**niveli i dytë
**:komentojmë diçka për nivelin e dytë
*niveli i parë
**niveli i dytë
***niveli i tretë
***: koment tjetër
```

dhe fitohet:

- niveli i parë
 - niveli i dytë
komentojmë diçka për nivelin e dytë
- niveli i parë
 - niveli i dytë
 - niveli i tretë
koment tjetër

Përfundimi është se, që të bëhet ndërprerje në një nivel të caktuar, duhet të shtohen aq një (ose shenja të tarabës te listat me numra rendorë) sa i përgjigjen atij niveli.

Krijimi i listave nëpërmjet shiritit me vegla për redaktim




Fotografia 2.17. Në shiritin me vegla për redaktim, nën menynë rënëse “E avancuar”, gjenden butonat (të shënuar me të kuqe) për futje të një anëtari nga lista me nënpika ose nga lista me numra rendorë

Futja e shenjave speciale

Shenjat speciale, si për shembull: © € ™ ™ ™ ™, mund të futen në tekst në disa mënyra.


Së pari, ato mund të futen nëpërmjet shiritit me vegla për redaktim (fotografia 2.18.).



Fotografia 2.18. Shenjat speciale mund t'i fusni nëpërmjet menysë me po atë emër (të shënuar me të kuqe) nga shiriti me vegla për redaktim.

Ato janë të radhitura në disa kategori (shkronja latine, МФА, simbole, qirilicë, shkronja greke, shkronja arabe etj.). Me shtypjen e simbolit që e dëshirojmë, ai paraqitet në kutinë për tekst.

Përveç shiritit me vegla, shumë wiki, në fund të dritares për redaktim, ofrojnë mundësi për futje të shpejtë të shenjave speciale. (Fotografia 2.19.).



Fotografia 2.19. Në fund të dritares për redaktim, nën butonat për ruajtje/pasqyrë, shumë wiki kanë simbole speciale. Me zgjedhjen e tyre, ato futen në dritaren për redaktim.

Dhe më në fund, simbolet speciale mund të futen edhe duke e futur kodin përkatës të simbolit të dhënë. Kjo është treguar në vazhdim.

Shkronja me shenja diakritike

Si duket	Çka futni
À Á Â Ã Ä Å Æ Ç È É Ê Ë Ì Í Î Ñ Ò Ó Ô Õ Ö Ø Ù Ú Û Ü ß à á â ã ä å æ ç è é ê ë ì í î ï ñ ò ó ô œ õ ö ø ù ú û ü ÿ	À Á Â Ã Ä Å Æ Ç È É Ê Ë Ì Í Î Ï Ñ Ò Ó Ô Õ Ö Ø Ù Ú Û Ü ß à á â ã ä å æ ç è é ê ë ì í î ï ñ ò ó ô œ õ ö ø ù ú û ü ÿ

Interpunksioni

Si duket	Çka futni
¿ ¡ § ¶ † ‡ • — — < > « » , ’ “ ”	¿ ¡ § ¶ † ‡ • – — ‹ › « » ‘ ’ “ ”

Simbolet komerciale

Si duket	Çka futni
™ © ® ¢ € ¥ £ ¤	™ © ® ¢ € ¥ £ ¤

Shkronjat greke

Si duket	Çka futni
α β γ δ ε ζ η θ ι κ λ μ ν ξ ο π ρ σ ς τ υ φ χ ψ ω Γ Δ Θ Λ Ξ Π Σ Φ Ψ Ω	α β γ δ ε ζ η θ ι κ λ μ ν ξ ο π ρ σ ς τ υ φ χ ψ ω Γ Δ Θ Λ Ξ Π Σ Φ Ψ Ω

Simbolet matematikore

Si duket	Çka futni
$\int \sum \prod \sqrt{-} \pm \infty$ $\approx \square \equiv \neq \leq \geq$ $\times \cdot \div \partial ' "$ $\square \% \circ \square \square \emptyset$ $\square \square \cap \square \square \square \square \square$ $\neg \square \square \square \square$ $\square \square \square \square \square$ $\rightarrow \downarrow \uparrow \leftarrow \leftrightarrow$	∫ ∑ ∏ √ − ± ∞ ≈ ∝ ≡ ≠ ≤ ≥ × · ÷ ∂ ′ ″ ∇ ‰ ° ∴ ℵ ø ∈ ∉ ∩ ∪ ⊂ ⊃ ⊆ ⊇ ¬ ∧ ∨ ∃ ∀ ⇒ ⇐ ⇓ ⇑ ⇔ → ↓ ↑ ← ↔

3

Linket

Asnjë wiki-projekt nuk do të ishte funksional nëse nuk do të kishte sistem efikas për lidhje të përmbajtjeve të ndryshme në kuadër të vetë wik-it, mirëpo edhe për lidhje me përmbajtjet e tjera në internet.

Wiki-softueri Media ofron zgjidhje të thjeshta për vendosje të linkeve (lidhjeve). Në këtë pjesë do të shqyrtohen **linket e brendshme** dhe **linket e jashtme**, si dy lloje kryesore të lidhjeve

Linket e brendshme

Linket e brendshme janë linke (lidhje) që mundësojnë qasje të drejtpërdrejtë deri te faqet e tjera të wik-it.

Në mënyrë përshkruese, ato janë linket e kaltra dhe të kuqe që paraqiten te artikujt. Kështu, **linket e kaltra** çojnë në **faqe që ekzistojnë** në këtë wiki, dhe kur të klikojmë tek ato, qasemi në mënyrë të drejtpërdrejtë te përmbajtja e asaj faqeje, ndërsa **linket e kuqe** çojnë në **faqe që nuk ekzistojnë** në wiki, dhe kur t'i shtypim ato, paraqitet një dritare e zbrazët për redaktim.

Si krijohen linket e brendshme?

Për krijimin e linkeve të brendshme, duhet që termi, i cili mund të ketë një ose më shumë fjalë, të futet brenda kllapave të dyfishta të mesme ([[termi]]). Për shembull:

[[Maqedonia]] = Maqedonia

Kështu, nëse klikoni në këtë link, do të qaseni në mënyrë të drejtpërdrejtë te faqja me titull “Maqedonia”. Megjithatë, gjatë redaktimit të tekstit, nuk ka gjithmonë mundësi që termi të paraqitet si titull i saktë i faqes, e kjo më shpesh, për shkak të rregullave gramatikore të gjuhës. Mirëpo, ekziston mundësia që mundëson krijim të linkut, që çon te titulli i saktë i faqes, edhe pse ajo është e krijuar duke “ngjyrosur” një term tjetër. Kjo mundësohet duke shtuar një vijë vertikale (“|”) para termit në kllapa, ashtu që në të majtë të vijës vertikale, futet titulli i saktë,

te i cili duhet të çojë linku. Kështu, për shembull:

```
[[Organizata e Kombeve të Bashkuara|OKB]] = OKB
```

Këtu, nëse e shtypni linkun, do ta fitoni faqen me titull “Organizata e Kombeve të Bashkuara”. Nëse termi që duhet të futet në kllapa dhe të paraqitet si link, është në formë të shquar, mund të futet me mënyrën e përmendur të shtimit të vijës vertikale, mirëpo zgjidhje më elegante është që mbaresa të lihet jashtë kllapave. Për shembull:

```
[[mur]]i = muri
```

Kështu, me zgjedhjen e linkut hapet faqja me e titull “muri”. Nëse ka nevojë që linket t’i paraqesim me shkronja të trasha ose kurzive, duhet që linku përkatës të vendoset brenda simboleve për apostrofë, ashtu që simbolet të jenë jashtë kllapave të mesme:

```
``[[Shkupi]]'' = Shkupi  
```[[Manastiri]]``` = Manastiri
```

Në mënyrë alternative, trashja apo pjerrësimi i linkeve mund të bëhet duke e përzgjedhur tërë linkun, e pastaj, në dritaren për redaktim, zgjedhet vegla përkatëse në shiritin me vegla.

## Linket e jashtme

Për dallim nga linket e brendshme, që mundësojnë qasje direkte te faqet që ekzistojnë te vetë wiki, linket e jashtme çojnë në cilëndo qoftë ueb-faqe në internet. Në formë përshkuese, linket e jashtme i paraqesin [linket me ngjyrë të kaltër të çelë](#), që paraqiten nëpër faqe, dhe kur shtypen ato, i qasemi ueb-faqes përkatëse jashtë wikit.

Shtimi i linkeve të jashtme bëhet në një pjesë të veçantë, të quajtur ==Linke të jashtme==, që shtohet në fund të faqes. Në të paraqiten linket për te ueb-faqet, përshkrimi i të cilave është titulli i përmbajtjes së ueb-faqes te e cila çon linku i jashtëm.

## Si krijohen lidhjet e jashtme?

Ngjashëm sikurse edhe linket e brendshme, krijimi i linkeve të jashtme bëhet me përdorimin e kllapave, mirëpo jo me kllapa të dyfishta, por me kllapa të njëfishta (`[linku]`). Për shembull:

```
[www.example.com Shembull] = Shembull
```

Pjesa e parë e linkut është adresa e ueb-faqes, ndërsa pjesa e dytë, e cila duhet të jetë e ndarë me një vend të zbrazët nga adresa, e paraqet përshkrimin e linkut, gjegjësisht, atë që do të paraqitet në ueb-faqe. Shtimi i linkeve të jashtme ka mundësi të bëhet edhe pa e futur adresën në kllapa ose pa mos dhënë përshkrim, që është gabim:

```
www.example.com = www.example.com
[www.example.com] = [1]
```


Të dyja mundësitë përmbajnë një mangësi të qartë në krahasim me shembullin e rekomanduar. Me qëllim që të mundësohet pasqyrë më e qartë e linkut të jashtëm, rekomandohet të shtohen edhe të dhëna plotësuese në lidhje me ueb-faqen, si p.sh. titulli i ueb-faqes, autori i përmbajtjes etj.

Këto të dhëna plotësuese, më shpesh shtohen menjëherë pas kllapave të linkut të jashtëm dhe ndahen me presje (,). Kështu, për shembull:


```
[www.example.com Shembull], Example.com = Shembull, Example.com
[www.example.com Shembull], Emri dhe mbiemri i autorit = Shembull,
Emri dhe mbiemri i autorit
[www.example.com Shembull], Viti = Shembull, Viti
```




## Krijimi i lidhjeve nëpërmjet shiritit me vegla

Mënyra e krijimit të linkeve që u përshkrua më lartë, ka të bëjë me futjen e drejtpërdrejtë të linkeve gjatë wiki-formatimit. Gjithsesi, wiki-sofueri mundëson krijimin e linkeve edhe nëpërmjet të shiritit me vegla, duke e shtypur butonin - 

Me shtypjen e këtij butoni, hapet një meny e veçantë (Fotografia 3.1.), në të cilën, në mënyrë automatike mund të zgjedhen opcionet e lartpërmendura për krijim të linkeve të brendshme dhe të jashtme. Megjithatë, me kalimin e kohës, redaktuesit me përvojë, më shpejt mund të krijojnë linke nëpërmjet wiki-formatimit.



Вметни врска x

Наслов на страницата:  Страницата постои

Планина

Текст на врската:

планините

Кон вики-страница  Кон надворешна страница

Откажи Вметни врска

Fotografia 3.1. Menyja për linke të brendshme dhe të jashtme

# 4

## Referimi dhe shënimet

### Ç'janë referimet dhe përse përdoren?

Pasiqë teknikisht, çdokush mund të shkruajë çkadoqoftë në një wiki, për disa wiki nevojitet që informatat që do të gjenden në artikuj të jenë të vërteta, gjegjësisht, të mos buronjë nga hulumtime vetjake, por nga burime të sigurta. Prandaj, imponohet nevoja që përmbajtja të jetë e kontrollueshme, gjegjësisht të bëhet referimi i burimeve që e vërtetojnë përmbajtjen që është futur, që mundëson kontrollim se sa është e vërtetë ajo, mirëpo ofron edhe më shumë të dhëna për përmbajtjen.

Citimi i burimeve bëhet me ndihmën e referimeve. Referimi paraqet një tekst të shkurtër i cili në mënyrë të veçantë tregon për një burim të caktuar të informatave.

#### Shembulli 1

- A. Kostallari, M. Domi, E. Çabej, E. Lafe: Drejtshkrimi i gjuhës shqipe. Rilindja, Prishtinë, 1974

Nga referimi i mësipërm morëm informatë për burimin, gjegjësisht për titullin e veprës dhe autorët e saj, botuesin, vendin dhe vitin e botimit.

Veprimi për shtimin e referimit është sqaruar në vazhdim:

- Menjëherë pas tekstit në të cilin dëshironi të shtoni referim, shtohet shënimi `<ref></ref>`, me ç'rast nevojitet që referimi të shkruhet ndërmjet dy shenjave `<ref>`. Ky citim do të paraqitet si indeks i sipërm, pranë fjalës që i paraprin.
- Nëse krijoni wiki-faqe të re, ose për herë të parë shtoni referim për te një faqe ekzistuese, atëherë, në fund të faqes shtojeni edhe këtë kod:

```
==Referimet==
{{referimet}}
```

Për shembull, në dritaren për redaktim e fusim këtë:

Në masakër janë vrarë 42 gra.<ref>Tërpe Tërpkovski: ''Masakra e Marsit''. Najdobri izdavaçi, Shkup, 2009, fq. 42.</ref>

*(përmbajtja në artikull)*

```
== Referimet ==
{{referimet}}
```

që në tekst duket kështu:

Në masakër janë vrarë 42 gra.<sup>[1]</sup>

## Referimi

- <sup>1</sup> ^ Tërpe Tërpkovski: Masakra e Marsit. Najdobri izdavaçi, Shkup, 2009

## Citimi i referimeve

### Referimi i plotë

Citimi i burimeve duke shtuar referime të shënuara paralelisht me tekstin, paraqitet në brendinë e tekstit, në formë të numrave të vegjël që mund të klikohen, e që çojnë te një listë e numëruar me citime të plota në fund tekstit.

Që një referim të paraqitet në fusnotë, duhet jetë i përshkuar me shenja „**ref**“. Këto shenja mund t'i shtoni duke futur `<ref>` në fillim të referimit dhe `</ref>` në fund.

Në mënyrë alternative, mund të vëreni se te shiriti me vegla (në fund të faqes për redaktim) ka një listë me kod, që mund të futet në mënyrë automatike, duke i përfshirë shenjat `<ref></ref>` - nëse e zgjedhni citimin e burimit dhe nëse klikoni në këtë shenjë, ajo automatikisht do ta mbyllë citimin Tuaj me shenjat `ref`.

Poashtu, mund ta shtoni emrin e referimit nëpërmjet atributit `name: <ref name="emri">detajet e citimit</ref>`. Pas kësaj, fusnotën e njëjtë mund ta shfrytëzoni disa herë vetëm duke shtuar `<ref name="emri"/>`.

Referimi i plotë do të paraqitet në shtojcën e artikullit, në seksionin me titull “Referimet” ose “Referencat” ose “Shënimet”.

Nëse kjo shtojcë nuk ekziston, krijojeni duke e krijuar seksionin ==Referimet==, dhe në pjesën e poshtme futni <references/>.

Shembulli në vazhdim tregon se si do të dukej kjo në kutinë për redaktim:

```
Fotosinteza është proces me të cilin ushqehen bimët.<ref>S. Stojçevski: ''Botanika''. Prosvetno Dello, Shkup, 2005, faqe 112</ref> Për të nevojiten drita e diellit dhe klorofili.<ref>A. Ivanova, Z. Tomovski:''Fiziologjia e bimëve''. Toper, Shkup, 2001, faqe 62</ref> Fotosinteza zhvillohet vetëm në pjesët e gjelbra të bimës.<ref> S. Stojçevski: ''Botanika''. Prosvetno Dello, Shkup, 2005, faqe 57</ref>
```

```
==Referimet==
{{referimet}}
```

Këtu është paraqitur se si do të duket teksti në faqe, kur do ta ruani faqen:

Fotosinteza është proces me të cilin ushqehen bimët.<sup>[1]</sup> Për të nevojiten drita e diellit dhe klorofili.<sup>[2]</sup> Fotosinteza zhvillohet vetëm në pjesët e gjelbra të bimës.<sup>[3]</sup>

## Referimet

---

- <sup>1</sup>. S. Stojçevski: Botanika. Prosvetno Dello, Shkup, 2005, faqe 112
- <sup>2</sup>. A. Ivanova, Z. Tomovski: Fiziologjia e bimëve. Toper, Shkup, 2001, faqe 62
- <sup>3</sup>. S. Stojçevski: Botanika. Prosvetno Dello, Shkup, 2005, faqe 57

## Referimi i shkurtër

Shumë tekste e përdorin versionin e shkurtuar për të cituar referime, duke e dhënë vetëm autorin, vitin (ose titullin) dhe numrin e faqeve. Sikurse edhe paraprakisht, lista me referime krijohet në mënyrë automatike, në pjesën e quajtur “Referimet”. Pastaj, në një pjesë tjetër të titulluar “Literatura”, shtohen të gjitha të dhënat që ndërlidhen me veprën e shkurtuar.

Referimet e shkurtra kanë më shumë përparësi, kështu që, redaktuesit i mundësojnë të citojë më tepër faqe të ndryshme nga burimi i njëjtë, pa mos e kopjuar tërë citimin; i shmangemi tekstit të gjatë në kodin e artikullit të citimeve të plota; i sjellin citimet e plota në një bllok koherent me kod (në vend që të jenë të shpërndara nëpër tërë tekstin), që mundëson ato të renditen sipas alfabetit, e më i lehtë është edhe përmirësimi i citimeve të plota përnjëherë (për shembull, shtimi i numrit ISBN ose shtimi i ndonjë detaji tjetër); një fusnotë mund të përmbajë më shumë citime, e me këtë u shmangemi kolonave të gjata me shënues të fusnotave.

Më poshtë është paraqitur se si duket dritarja për redaktim gjatë shtimit të “referimeve të shkurtra” në një tekst:

```
Fotosinteza është proces me të cilin ushqehen bimët.<ref>Stojçevski
2005, faqe 112.</ref>
```

```
Për të nevojiten drita e diellit dhe klorofili.<ref>Ivanova, To-
movski 2001, faqe 62.</ref>
```

```
Fotosinteza zhvillohet vetëm në pjesët e gjelbra të
bimës.<ref>Stojçevski 2005, faqe 57.</ref>
```

(përmbajtje në artikull)

```
== Referimet ==
{{referimet}}
```

```
== Literatura e shfrytëzuar ==
*S. Stojçevski: ''Botanika''. Prosvetno Dello, Shkup, 2005.
*A. Ivanova, Z. Tomovski:''Fiziologjia e bimëve''. Toper, Shk-
up, 2001.
```

që jep:

Fotosinteza është proces me të cilin ushqehen bimët.<sup>[1]</sup> Për të nevojiten drita e diellit dhe klorofili.<sup>[2]</sup> Fotosinteza zhvillohet vetëm në pjesët e gjelbra të bimës.<sup>[3]</sup>

### Referimet

---

- <sup>1</sup> Stojçevski 2005, faqe 112.
- <sup>2</sup> Ivanova, Tomovski 2001, faqe 62.
- <sup>3</sup> Stojçevski 2005, faqe 57.

### Literatura e shfrytëzuar

---

- S. Stojçevski: Botanika. Prosvetno Dello, Shkup, 2005
- A. Ivanova, Z. Tomovski: Fiziologjia e bimëve. Toper, Shkup, 2001

Referimet e shkurtra që shfrytëzojnë tituj në vend të datave të botimit, mund të duken kështu:

### Referimet

---

- <sup>1</sup> Stojçevski, Botanika, faqe 1122.
- <sup>2</sup> Ivanova, Tomovski, Fiziologjia e bimëve, faqe 62.
- <sup>3</sup> Stojçevski, Botanika, faqe 57.

## Citimi i përgjithshëm i burimeve

Nëse ndonjë burim mbulon një pjesë të konsiderueshme të materialit në ndonjë tekst, ndonjëherë, ndoshta është e pranueshme që citimi të shtohet në fund.

Shërben si citim i përgjithshëm, që nuk është i lidhur me ndonjë pjesë specifike të tekstit.

Kjo është më e përshtatshme për tekste relativisht të pakompletura ose për ato tekste që mbulojnë një temë shumë të ngushtë. Për shembull, në dritaren për redaktim fusim:

---

Fotosinteza është proces me të cilin ushqehen bimët. Për të nevojiten drita e diellit dhe klorofili. Fotosinteza zhvillohet vetëm në pjesët e gjelbra të bimës.

== Literatura e shfrytëzuar ==

\*S. Stojçevski: ''Botanika''. Prosvetno dello, Shkup, 2005.

\*A. Ivanova, Z. Tomovski: ''Fiziologjia e bimëve''. Toper, Shkup, 2001.

Pas ruajtjes, ndryshimet e kanë këtë pamje:

Fotosinteza është proces me të cilin ushqehen bimët. Për të nevojiten drita e diellit dhe klorofili. Fotosinteza zhvillohet vetëm në pjesët e gjelbra të bimës.

*(përmbajtja e artikullit)*

### **Literatura e shfrytëzuar**

---

- S. Stojçevski: Botanika. Prosvetno Dello, Shkup, 2005
- A. Ivanova, Z. Tomovski: Fiziologjia e bimëve. Toper, Shkup, 2001


# 5

## fotografitë dhe multimedia

Përveç përmbajtjeve tekstuale, në faqe mund të shtohen edhe fotografi, si dhe video dhe audio inçizime. Mënyra e shtimit të tyre është më e ndërlikuar se sa futja e tekstit, e bile dallon edhe mënyra e shtimit të fotografive me mënyrën e shtimit të përmbajtjeve të tjera multimediale.

Përmbajtjet e ngarkuara (upload) vendosen në hapësirën e emrit “Fajlli:”. Kjo do të thotë se faqet në të cilat gjenden përmbajtjet multimediale fillojnë me prefiksin e njëjtë. Kështu, për t’u qasur titullit të ndonjë përmbajtjeje multimediale, duhet që në shiritin për shfletim, së pari të shkruhet ky prefiks, dhe menjëherë pas tij, titulli i fajllit me të cilin ai është ngarkuar.

### Shtimi i fotografisë

Shtimi automatik i fotografisë bëhet duke e zgjedhur veglën , në shiritin me vegla për redaktim, me ç’rast shtohet teksti:

```
[[Fajlli:Shembulli.jpg]]
```

Është e qartë se shënimi paraqet një lloj linku të brendshëm, e prej këtu rrjedh edhe ideja që gjatë shtimit të fotografive, të redaktohet edhe ky link i brendshëm. Megjithatë, për shkak se bëhet fjalë për shtim të fotografisë dhe të të gjitha parametrave të nevojshme, veprimi për plotësim është më i ndërlikuar, mirëpo në vazhdim është sqaruar në tërësi.

Shënimi i futur në mënyrë automatike në linkun e brendshëm “Fajlli:Shembulli.jpg”, është titulli i fotografisë, ku “Fajlli:” është prefiksi për hapësirën e emrit (namespace), ndërsa “Shembulli.jpg” është emri me të cilin është ngarkuar fotografia. Duke e zëvendësuar pjesën e dytë me titullin e vërtetë të fotografisë dhe pasi të ruhen ndryshimet, fotografia do të shtohet në artikull. Kështu, për shembull:







```
[[Fajlli:Bandera de Tetovo.svg]] =
```




Me futjen e titullit “Bandera de Tetovo.jpg” dhe pasi të ruhen ndryshimet, do të paraqitet fotografia e cila është ngarkuar me këtë emër. Për përshtatjet e tjera të fotografisë, që përfshijnë



kornizimin, vendosjen në mes, zmadhimin ose zvogëlimin dhe dhënien e përshkrimit, si edhe te linket e brendshme, shtohet një vijë vertikale („|“), menjëherë pas emrit të fotografisë. Në vazhdim janë paraqitur përshtatjet që mund të bëhen te fotografitë që janë shtuar:

Si duket	Çka futet
	[[Fajlli:Bandera de Tetovo.svg mini]]
	[[Fajlli:Bandera de Tetovo.svg mini majtas]]
	[[Fajlli:Bandera de Tetovo.svg mini djathtas]]
	[[Fajlli:Bandera de Tetovo.svg mini qendër]]
	[[Fajlli:Bandera de Tetovo.svg mini djathtas 200p]]
	[[Fajlli:Bandera de Tetovo.svg mini djathtas 200p Flamuri i Tetovës]]

## Shtimi i përmbajtjeve të tjera multimediale

Ngjashëm sikurse edhe shtimi i fotografive, shtimi automatik i përmbajtjeve të tjera multimediale bëhet duke zgjedhur veglën , me ç'rast futet shënimi:

```
[[Fajlli:Shembulli.jpg]]
```

Siç u tha më lartë, përmbajtjet e ngarkuara multimediale janë të vendosura në faqe të një hapësire të veçantë të emrit, gjegjësisht e përmbajnë prefiksin “Fajlli:”. Kështu, sikurse edhe gjatë shtimit të fotografive, për të shtuar përmbajtje të tjera multimediale (audio dhe video inçizime), duhet të zëvendësohet pjesa e dytë në linkun e brendshëm, “Shembulli.jpg”, me emrin me të cilin është ngarkuar përmbajtja.

Pastaj, mund të bëhen edhe përshtatje të tjera të përmbajtjes, në bazë të të cilave ajo do të paraqitet në faqe, pas ruajtjes së redaktimit.

## Ngarkimi i përmbajtjeve multimediale

Tashmë, u tha se përmbajtjet multimediale shtohen në të njëjtën mënyrë siç shtohen edhe linket e brendshme, mirëpo me atë dallim se, nëse një përmbajtje e caktuar ekziston, ajo paraqitet në formë tjetër, për dallim nga linket e brendshme, që paraqiten me ngjyrë të kaltër. Megjithatë, nëse një përmbajtje multimediale nuk ekziston, linku do të ngjyroset me të kuqe, njësoj si edhe te linket e brendshme tekstuale. Këtu duhet theksuar se përmbajtjet multimediale që nuk ekzistojnë te wiki, në fakt nuk janë të ngarkuara, dhe në bazë të kësaj, lirisht mund të thuhet se, për t’u krijuar një përmbajtje e këtillë, ajo duhet të ngarkohet.

Ngarkimi i përmbajtjes multimediale është veprim i ndërlikuar, që kërkon njohje më të thellë të përmbajtjeve përkatëse, të të drejtave autoriale dhe të formatit të tyre momental. Përvetësimi i të drejtave autoriale është një lëmi mjaft e gjerë, prandaj për to do të flasim vetëm në mënyrë sipërfaqësore, ndërsa veprimi për ngarkim do të sqarohet detajisht.

Veprimi për ngarkim bëhet në një faqe të veçantë të projektit, që gjendet në një hapësirë të veçantë të emrit, që fillon me prefiksin “Speciale:”. Pas tij, duhet të futet titulli i faqes, në të cilën mund të ngarkohen përmbajtjet.

Me hapjen e faqes për ngarkim, në fakt hapet një formular i veçantë, që duhet të plotësohet, në mënyrë që fajlli të mund të ngarkohet. Në fillim të faqes, zakonisht ka një udhëzues, që tregon se çka duhet të bëhet në vazhdim dhe cilat përmbajtje duhet të ngarkohen. Në vazhdim do të flasim për formularin, i cili është i ndarë në tri pjesë, dhe secila pjesë do të sqarohet në

---

vazhdim.

Pjesa e parë (Fotografia 5.1) ka të bëjë me të dhënat burimore të fajllit. Duke e zgjedhur fushën “Choose File”, hapet një dritare ku mund ta zgjedhim fajllin e dëshiruar. Këtu duhet shënohet emri përkatës i fajllit, që do ta përshkruajë përmbajtjen, si dhe përshtatja eventuale e formatit, me ato që është e lejuar.

Përmbajtjet që mund të ngarkohen, nuk mund të jenë në çfarëdo lloj formati, por vetëm në njërin nga formatet e dhëna në këtë pjesë, prandaj përshtatja është shumë me rëndësi. Gjithashtu, madhësia maksimale e fajllit nuk duhet të kalojë 100 MB.

Source file

Изворно име:  Browse...

Maximum file size: 100 MB (a file on your computer)

Дозвољени типови на датотеки: png, gif, jpg, jpeg, xcf, pdf, mid, ogg, ogv, svg, djvu, tiff, tif, oga.

*Fotografia 5.1. Të dhënat burimore për fajllin*

Në pjesën e dytë (Fotografia 5.2.) duhet të plotësohet formulari për ngarkim, ku duhet të jepet përshkrim i fajllit, data e krijimit (më shpesh viti) dhe autori. Pasi të plotësohet formulari, në rreshtin e fundit të kësaj pjese, patjetër duhet të zgjedhet licenca përkatëse, sipas të cilës do të licencohet përmbajtja e projektit.

Duhet theksuar se mund të ngarkohen vetëm përmbajtjet e lira, ndërsa ato jo të lirë, me ngarkimin e të cilave do të shkileshin të drejtat autoriale, nuk është e lejuar të ngarkohen. Mirëpo, ekziston mundësia të theksohet qëllimi për të cilin vepra jo e lirë do t'i shërbejë projektit, dhe në atë rast të ngarkohet për përdorim të drejtë.




# 6

## Tabelat

Wiki-tabela paraqet një mënyrë për t'i futur dhe për t'i organizuar të dhënat, në formë të kolonave dhe të rreshtave. Me shfrytëzimin e tabelave mundësohet një pasqyrë më e mirë e të dhënave të paraqitura, ndërsa përdorimi i tyre rekomandohet gjatë krijimit të listave. Ekzistojnë lloje të ndryshme të tabelave dhe mënyra të ndryshme, në të cilat ato mund të përshtaten.

### Shtimi i tabelës

Për të futur një tabelë në mënyrë automatike, duhet të zgjedhet vegla , në shiritin me vegla për redaktim, me ç'rast, në dritaren për redaktim shtohet teksti me këtë përmbajtje:

```
{| class="wikitable"
|-
! titulli 1
! titulli 2
! titulli 3
|-
| rreshti 1, qeliza 1
| rreshti 1, qeliza 2
| rreshti 1, qeliza 3
|-
| rreshti 2, qeliza 1
| rreshti 2, qeliza 2
| rreshti 2, qeliza 3
|}
```

Pasi të ruhet përmbajtja, në artikull fitohet një tabelë e vërtetë, ku të dhënat e përmendura i paraqesin elementet përkatëse

Titulli 1	Titulli 2	Titulli 3
rreshti 1, qeliza 1	rreshti 1, qeliza 2	rreshti 1, qeliza 3
rreshti 2, qeliza 1	rreshti 2, qeliza 2	rreshti 2, qeliza 3
rreshti 3, qeliza 1	rreshti 3, qeliza 2	rreshti 3, qeliza 3

Për ta plotësuar tabelën me të dhëna, duhet që në vend të shënimeve të lartëpërmendura, në dritaren për redaktim, të futen të dhënat përkatëse.

## Simbolet kryesore

Që të mund të kuptohet më lehtë mënyra e redaktimit të tabelave, së pari duhet të kuptohet domethënia e simboleve me të cilat është shënuar tabela.

Në tabelën e mëposhtme, është dhënë një sqarim i shkurtër për secilin simbol.

Simboli	Përshkrimi	Vërejtje
{	fillimi i tabelës	futet në fillim të rreshtit të parë
}	fundi i tabelës	futet në rreshtin e fundit
-	rreshti i ri	futet në rresht të veçantë
!	qeliza me titull	futet në fillim të rreshtit
	Qeliza	futet në fillim të rreshtit
class="wikitable"	shenja për tabelë	futet në rreshtin e parë
style="font-size: %"	shenja për madhësinë e tabelës	futet në rreshtin e parë dhe shprehet me atë se, në tërë faqen, sa pjesë merr madhësia e tabelës.

Një shembull i thjeshtë për përdorimin e simboleve prej të cilave përbëhet tabela, është tabela e paraqitur më lartë, me atë dallim që, në të nuk ka shenjë për madhësinë e tabelës, që duhet të futet në rreshtin e parë, menjëherë pas shenjes për tabelë

# 7

## Kategoritë

### Çka paraqesin kategoritë?

Një nga elementet kyçe për mirëmbajtjen e përmbajtjeve në Wikipedia janë kategoritë. Ato paraqesin lista artikujsh (ose faqe të tjera) dhe kategori të krijuara në bazë të një atributi të përbashkët. Përveç faqeve, mund të kategorizohen edhe kategoritë, gjegjësisht një kategori mund të përmbajë disa kategori të tjera, të quajtura “nënkategori”. Kryesisht, numri më i madh i kategorive kanë karakteristikë të nënkategorisë, që mundëson ato të organizohen në formë të pemës, që, nga ana tjetër, e lehtëson qasjen te kategoritë

Kategoria 1	Kategoria 1 është kategori kryesore.
Kategoria 2	Kategoria 2 është kategorizuar në Kategorinë 1.
Kategoria 3	Kategoria 3 është kategorizuar në Kategorinë 2.
Kategoria 4	Kategoria 4 është kategorizuar në Kategorinë 3.

Një karakteristikë tjetër e rëndësishme e kategorive është se, ngjashëm si edhe përmbajtjet multimediale, ato janë pjesë e një hapësire të veçantë të emrit, prandaj, që të kemi qasje te ndonjë kategori, duhet që shfletimi të bëhet duke shkruar “Kategoria:” para titullit të kategorisë. Kështu, që të hapet kategoria e titulluar “Veles”, në shiritin për shfletim duhet të shkruhet “Kategoria:Veles”, e jo vetëm “Veles”, që çon te artikulli me atë titull.

### Shtimi i kategorive

Kategoritë mund të shtohen në mënyrë automatike duke e zgjedhur veglën `[[Kategoria:]]`, të vendosur në shiritin me vegla për Wikifikim të tekstit. Me zgjedhjen e kësaj vegle, në artikull shtohet një shënim me po atë përmbajtje:

```
[[Kategoria:]]
```

Ngjashëm si edhe te fajllat, ideja gjatë shtimit të kategorive është që të shtohen linke të brend-

shme, ashtu që përmbajtja e linkut të brendshëm është tërë titulli i kategorisë, ashtu siç është vendosur në hapësirën e veçantë të emrit, gjegjësisht, siç u sqarua më lartë, mënyra në të cilën mund t'i qasemi duke shkruar në shiritin për shfletim. Për shembull:

```
[[Kategoria:Veles]]
```

Është e qartë se emri i kategorisë është futur në linkun e brendshëm, së bashku me prefiksin “Kategoria:”, ose gjatë shtimit automatik të kategorisë është shtuar pas prefiksit. Me ruajtjen e ndryshimeve me të cilat shtohen kategoritë, ato paraqiten si linke të brendshme në fund të faqes, ku në fillim është shkruar titulli i hapësirës së emrit ku janë vendosur, ndërsa në vazhdim janë shkruar titujt e kategorive në të cilat është kategorizuar faqja, të ndarë me vijë vertikale (“|”). Nëse ekziston ajo kategori, ngjashëm si edhe te linket e brendshme, ajo është e ngjyrosur me të kaltër, ndërsa nëse kategoria nuk ekziston, me të kuqe (Fotografia 7.1.).

## Надворешни врски

[уреди]

- [Крале Марко: „Свети Климент Охридски“](#) 

Категории: [Цркви на Македонската Православна Црква](#) | [Цркви во Скопската епархија](#) | [Цркви во Скопското архиерејско намесништво](#) | [Цркви во Општина Центар](#) | [Цркви во Македонија](#) | [Цркви во Скопје](#)

Fotografia 7.1. Pasqyra e kategorive në një artikull

## Krijimi i kategorisë

Nëse ndonjë kategori nuk ekziston (e ngjyrosur me të kuqe), paraqitet nevoja për krijimin e saj. Ngjashëm sikurse edhe te faqet, redaktimi në formular mund të bëhet duke e klikuar linkun e kuq ose duke e futur titullin në shiritin për shfletim. Pasi të hapet dritarja për redaktim, në të futen vetëm kategori, gjegjësisht kategoria kategorizohet.

Është me rëndësi të theksohet se gjatë redaktimit të kategorisë, nuk shtohen titujt e faqeve, të cilat duhet të kategorizohen në kategorinë përkatëse, për arsye të thjeshtë se, me vetë shtimin e kategorisë në faqe, që u sqarua më lartë, faqet janë të kategorizuara.

Për shkak se kategoria paraqet faqe, që është e vendosur në një hapësirë të veçantë të emrit, renditja e përmbajtjes në të dallon, si me atë të artikujve, poashtu edhe me atë të fajllave.

Thënë thjeshtë, faqja e kategorisë përbëhet nga dy pjesë (Fotografia 7.2.). Në pjesën e parë



janë paraqitur të gjitha nënkategoritë (pjesa e ngjyrosur e kornizës së gjelbër) të renditura sipas alfabetit, ndërsa në pjesën e dytë, të gjitha faqet, të kategorizuara në kategorinë përkatëse (pjesa e ngjyrosur në kornizë të kaltër), gjithashtu të renditura sipas alfabetit.

Është interesante të përmendet se përmbajtja e këtyre dy pjesëve nuk futet gjatë redaktimit të kategorisë, por del nga kategorizimi i bërë i nënkategorive dhe i faqeve.

## Категорија:Велес

[Непрегледани страници](#) | [Промени во исчекување](#)

### Поткатегории

Оваа категорија ги содржи следниве 13 поткатегории од вкупно 13.

#### В

- [\[✖\] Велешани](#) (0)

#### Г

- [\[✖\] Географија на Велес](#) (0)

#### З

- [\[+\] Згради и градби во Велес](#) (3)
- [\[✖\] Велешки знаменитости](#) (0)

#### И

- [\[✖\] Историја на Велес](#) (0)

#### К

- [\[✖\] Култура на Велес](#) (0)

#### О

- [\[+\] Образование во Велес](#) (1)

#### П

- [\[✖\] Починати во Велес](#) (0)

#### Р

- [\[+\] Религија во Велес](#) (1)
- [\[✖\] Родени во Велес](#) (0)

#### С

- [\[+\] Спорт во Велес](#) (2)

#### Т

- [\[+\] Туризам во Велес](#) (1)

#### У

- [\[✖\] Училишта во Велес](#) (0)

### Статии во категоријата „Велес“

Оваа категорија ја содржи само следната страница.

#### В

- [Велес](#)

Категории: [Градови во Македонија](#) | [Општина Велес](#)

Фотографија 7.2. Фаја е категорије

Me të kuqe është ngjyrosur pjesa e tretë e faqes, dhe njëllor sikurse te faqet, ato janë kategoritë në të cilat është kategorizuar faqja, në këtë rast kategoria. Kjo është edhe pjesa e vetme e faqes që futet gjatë redaktimit të kategorisë.

## Renditja e përmbajtjes

Tashmë përmendëm se, te faqja e kategorisë, nënkategoritë dhe faqet e kategorizuara janë të renditura sipas alfabetit.

Megjithatë, mund të ketë edhe përjashtim nga kjo rregullë, gjegjësisht disa faqe dhe nënkategori mund të renditen në mënyrë tjetër, duke filluar nga shkronja e parë e deri te titulli i tyre.

Për shkak se kategoritë paraqesin linke të brendshme, kjo bëhet duke shtuar një vijë vertikale, mirëpo pas titullit të kategorisë dhe futjes së të ashtuqajturit shënim për renditje pas vijës vertikale. Për shembull:

```
[[Kategoria:Shtip|1000]]
```

Duke e shtuar kategorinë me këtë shënim, edhe pse artikulli titullohet “Shtip”, ai nuk do të kategorizohet nën shkronjën “Sh”, por nën numrin “1” (Fotografia 7.3.)

### Статии во категоријата „Штип“

Оваа категорија ја содржи само следната страница.

①

- Штип

Категорија: Градови во Република Македонија (-) (±) | (+)

*Fotografia 7.3. Paraqitja e kategorisë “Shtip”, në të cilën artikulli me të njëjtin emër, është kategorizuar dhe renditur nën numrin “1”*

## Përdorimi i avancuar

### Kategoria e fshehur

Pasi u sqarua roli i kategorive dhe shtimi i tyre, shtrohet pyetja se a mund të shtohet një kategori, e ajo të mos paraqitet në faqe pas ruajtjes. Përgjigja është pozitive për shkak të ekzistimit të të ashtuquajturave “kategori të fshehura”, të cilat paraqesin kategori të shtuara, mirëpo që nuk paraqiten. Mënyra më e thjeshtë për ta bërë një kategori të fshehur, është duke e shënuar dhe duke e përzgjedhur veçlën `<noinclude></noinclude>` në shiritin me vegla të formularit për redaktim, me ç’rast fitohet:

```
<noinclude>[[Kategoria:Emri i kategorisë]]</noinclude>
```

Pas ruajtjes së përmbajtjes, “kategoria e fshehur” nuk do të paraqitet në mesin e kategorive të tjera.

### Kategoria si link i brendshëm

Ndonjëherë, në faqet për bisedë, paraqitet nevoja që disa kategorive me tekst të shënohen si linke të brendshme. Për këtë qëllim, duhet të bëhet dekategoriizimi, gjegjësisht heqja e kategoriizimit, gjë që mund të bëhet duke i shtuar dy pika (“:”) në linkun e brendshëm të kategorisë, para shënimit që mbetet. Për shembull:

```
[[[:Kategoria:Emri i kategorisë]]] = [[Kategoria:Emri i kategorisë]]
```

Këtu, kategoria e dekategorizuar nuk do të paraqitet në pjesën e poshtme të faqes, me kategori të tjera, por si link i zakonshëm i brendshëm.

### Pema me kategori

Siç u përmend, kategoria mund të përmbajë disa nënkategori ose të jetë nënkategori e ndonjë kategorie tjetër, gjegjësisht organizimi i kategorive realizohet nëpërmjet strukturës së pemës. Kjo strukturë quhet “pema me kategori” dhe krijohet me futjen e shënimit

```
<categorytree>Emri i kategorisë</categorytree>,
```


ku në vend të “Emri i kategorisë”, duhet të shkruhet kategoria e dëshiruar, e cila do të paraqesë fillim të pemës. Kështu për shembull, nëse pema quhet “Manastiri”, atëherë në pemë është

kategoria me po të njëjtin emër, ndërsa kur të ruhet do të paraqiten të gjitha nënkategoritë e kësaj kategorie (Fotografia 7.4.).

Nënkategoritë mund të përmbajnë vetëm faqe të kategorizuara në to, por edhe nënkategori të tyre, prandaj edhe dallojmë dy lloje nënkategorish, të paraqitura në pemë.

Ato që nuk kanë nënkategori, janë të shënuara me shenjën “x” para titullit të tyre (të ngjyrosur me të kuqe), ndërsa ato që kanë nënkategori, janë të shënuara me shenjën “+” (të ngjyrosur me të kaltër), me zgjedhjen e së cilës hapet nënkategoria.

Kategoria e hapur dhe nënkategoritë e hapura janë të shënuara me shenjën “-“ para titullit (të ngjyrosur me të gjelbër).



Nënkategoritë e nënkategorive të hapura, gjithashtu mund të jenë, me dhe pa kategori, dhe janë të shënuara me po të njëjtat shenja (“x” ose “+”) dhe veprimi vazhdon më tutje, gjersa të mos shterren të gjitha nënkategoritë.

# 8

## faqja për bisedë

Që në fillim u tha se, faqja për bisedë e paraqet llojin e dytë të faqeve sipas qëllimit të tyre.

Bëhet fjalë për një faqe të veçantë, e cila hapet duke e shtypur tab-in “Bisedë”. Duhet të theksohet se edhe tab-et me vetitë e kësaj faqeje, dallohen me ato të artikullit, që është edhe normale, sepse bëhet fjalë për faqe të veçantë.

Kështu, duke e shtypur tab-in “Redakto”, hapet dritarja për redaktim të kësaj faqeje, ndërsa në histori, regjistrohen ndryshimet që janë bërë në të.


Qëllimi i faqes për bisedë, siç thotë edhe vetë emri, është që të zhvillohet bisedë rreth përmbajtjes së artikullit, gjegjësisht, si duhet të duket ajo, dhe cilat ndryshime duhet bërë. Për shkak se përmbajtja e artikullit mund të kontestohet, faqja për bisedë paraqet vend ku ajo edhe formalisht mund të kontestohet.

Faqja, gjithashtu, shërben edhe për të dhënë propozime për ndryshime të përmbajtjes, ndryshim të mundshëm të titullit të artikullit, bashkangjitje të literaturës plotësuese me të cilën përforcohet vërtetësia e përmbajtjes, por ndonjëherë është edhe vend për zgjidhje të ndonjë kontesti, për pikëvështrime të kundërta për ndonjë pjesë të artikullit.

Megjithatë, nuk duhet kuptuar se faqja për bisedë është vendi ku duhet të përmendet çdo ndryshim që është bërë në faqe, por mu e kundërta, paraqet hapësirë për diskutim rreth disa çështjeve kontestuese, për të cilat, kryesisht ka më shumë mendime.

Poashtu, është shumë me rëndësi se faqja nuk paraqet as blog, as forum, kështu që nuk lejohehet shkruarja e komenteve të parëndësishme, që nuk janë drejtpërdrejt të lidhura me përmbajtjen e artikullit.

Gjatë fillimit të bisedës duhet të shkruhet ==titulli i ri==.

Pas dhënies së komenteve Tuaja, patjetër nënshkruani ato, duke e zgjedhur dhe duke e shtuar veglën , menjëherë pas komentit.

Në vazhdim është dhënë një shembull i thjeshtë për mënyrën se si mund të zhvillohet një diskutim në faqen për bisedë.

## Shembulli 1

== Përmbajtje joadekuate ==

Konsideroj se përmbajtja e artikullit nuk është adekuate dhe duhet të ndryshojë.-- Shfrytëzuesi1

Bëra disa ndryshime me të cilat mendoj se është përmirësuar. -- Shfrytëzuesi2  
Të faleminderit. Tani mendoj se janë përfshirë më tepër gjëra. -- Shfrytëzuesi1

# 9

## Administrimi

Që të mundësohet funksionimi normal i wiki-projekteve dhe realizimi i qëllimeve të tyre, nevojitet një nivel i caktuar i administrimit me njerëzit dhe ekonomiko-juridik. Gjithsesi, që të ekzistojë një wiki-projekt, atë duhet ta themelojë ndonjë person i caktuar ose organizatë (organizatë joqeveritare, fondacion, kompani etj.), që do ta blejë domenin, do t'i sigurojë parakushtet e dosmosdoshme për funksionim të wiki-softuerit, d.t.th. kërkesat filltare të softuerit, do të sigurojë hapësirë të nevojshme të serverit dhe do t'i rregullojë aspektet pronësore dhe juridike të wiki-projektit (për shembull, pronësinë mbi të dhënat dhe përmbajtjet e wiki-projektit).

Përveç rasteve kur wiki-projektet përdoren për nevoja interne, **themeluesi** (ose themeluesit) nuk do ta fillonte një wiki-projekt nëse nuk konsideron se në të do të punojnë disa **redaktues**, që do të krijojnë më shumë përmbajtje për një numër më të madh të **lexuesve**. Redaktuesit e regjistruar, që kontribuojnë duke redaktuar me emrin e tyre të shfrytëzuesit, quhen **shfrytëzues**. Në projekt ekzistojnë dhe grupe të redaktuesve, që janë të regjistruar me emër të shfrytëzuesit, të quajtur **bot-e**, kontributet e të cilëve, kryesisht përbëhen nga shtimi automatik i përmbajtjeve, të cilat për nga vëllimi janë dukshëm më të vogla se sa ato të shfrytëzuesve të zakonshëm.

Redaktuesit që i krijojnë përmbajtjet e projektit janë në komunikim të vazhdueshëm të ndërsjellë, prej ku edhe del nevoja për rregullimin e marrëdhënieve të tyre të ndërsjella. Me këtë, janë krijuar rregullat për sjellje të redaktuesve, gjegjësisht rregullat që kanë të bëjnë me funksionimin e tërë projektit.

Respektimi i rregullave është i obligueshëm, mirëpo ka edhe përjashtime, poqese kështu vendos pjesa më e madhe e **komunitetit**. Atë, në fakt, e përbëjnë të gjithë shfrytëzuesit që marrin

pjesë në diskutim për ndonjë temë të caktuar. Kështu, komuniteti vendos për futjen e rregullave të reja, ndryshimin e disa elementeve kyçe në përmbajtjen e faqeve, fshirjen e faqeve të caktuara ose avancimin e shfrytëzuesve të caktuar. Për shkak të dukurisë së intervenimit të shpeshtë nga ana e tërë komunitetit, ai, zakonisht, zgjedh një grup të shfrytëzuesve me përvojë, që ka për detyrë ta mirëmbajë mënyrën se si funksionon, edhe projekti edhe marrëdhëniet ndërmjet redaktuesve të quajtur **administratorë**.

Administratorët, në fakt, janë shfrytëzues të avancuar, të cilët, për dallim nga shfrytëzuesit e zakonshëm, kanë disa mundësi plotësuese teknike që përfshijnë fshirjen e faqeve, bllokimin e shfrytëzuesve të tjerë, e poashtu shërbejnë edhe si shfrytëzues që ndërmjetësojnë kur paraqiten konteste ndërmjet shfrytëzuesve. Ata janë të zgjedhur nga ana e komunitetit, nëpërmjet diskutimit dhe votimit, dhe statusin e përfituar e mbajnë në afat të pacaktuar. Përveç administratorëve, ekziston edhe një grup i shfrytëzuesve të avancuar, të quajtur **burokratë**, mundësitë teknike të të cilëve janë edhe më të mëdha, dhe përfshijnë avancimin e shfrytëzuesve të zakonshëm në administratorë, ndryshimin e emrave të shfrytëzuesve dhe miratimin e statusit bot. Ngjashëm, si edhe administratorët, edhe burokratët zgjidhen nga ana e komunitetit, dhe njëllon, edhe statusin e mbajnë në afat të pakufizuar.

## Administratorët

Siç u tha më lartë, administratorët paraqesin një grup të veçantë të shfrytëzuesve, që kanë disa mundësi plotësuese teknike, me qëllim që të mundësojnë funksionimin e rregullt të projektit, në përputhje me rregullat e miratuara. Për atë se kush mund të jetë administrator, vendos tërë komuniteti, i cili, gjithashtu, e rregullon edhe udhëzuesin për administratorët e tij dhe mënyrën se si zgjidhen ata.

## Si bëhesh administrator?

Procedura për përfitim të të drejtave dhe të statusit të administratorit mund të dallojë, varësisht se si është miratuar ajo nga ana e komunitetit. Megjithatë, ekziston një kornizë e përcaktuar, që duhet të respektohet gjatë krijimit të saj, e që është e përbashkët për numrin më të madh të projekteve, dhe është e ndarë në dy faza: vendosja e kërkesave që duhet të plotësohen dhe parashtrimi i kandidaturës.

Faza e parë përfshin përcaktimin e kërkesave të caktuara, të cilat duhet t'i plotësojë shfrytëzuesi që të bëhet administrator. Këto kërkesa janë të njëjta për të gjithë kandidatët potencialë dhe në fakt paraqesin rregulla të miratuara nga ana e komunitetit. Kështu, për shembull, komuniteti mund t'i ketë përcaktuar këto kërkesa, që duhet të plotësohen për t'u bërë admin-

---

istrator:

- kandidati ta ketë të krijuar emrin e shfrytëzuesit, para një kohe të caktuar;
- të ketë qenë aktiv brenda disa muajve të fundit;
- të ketë një numër të caktuar të redaktimeve të dobishme;
- ta njohë numrin më të madh të rregullave që vlejnë në atë wiki.

Kryesisht, këto kërkesa janë lehtë të kontrollueshme dhe të matshme (dy kërkesat e para të shembullit), mirëpo ato mund të përfshijnë edhe kërkesa të ndonjë karakteri tjetër, për përmbushjen e të cilave nevojitet diskutim, në të cilin mendimin e tyre do ta japin një numër më i madh shfrytëzuesve (kërkesa e tretë dhe e katërt e shembullit)..

Kandidatët potencialë të cilët i përmbushin kërkesat e përcaktuara mund të kalojnë në fazën e dytë, gjegjësisht ta parashtrojnë kandidaturën për administrator.

Pas parashtrimit të kandidaturës, së pari kontrollohet se kandidati a i ka përmbushur kriteret e përcaktuara, me ç'rast merren parasysh vetëm ato që mund të kontrollohen lehtë, ndërsa për ato më të dyshimtit, diskutohet në faqen e vetë kandidaturës, që përmban pyetje personale për kandidatin, hapësirë për diskutim dhe hapësirë për votim.

Më shpesh, komuniteti përcakton disa pyetje, të cilave duhet t'u përgjigjet secili kandidat, si për shembull:

- Me cilat kontribute të deritanishme të projektit jeni më të kënaqur?
- Me cilat vegla të administratorit do të shërbeheshit më shumë dhe pse?
- A keni qenë deri tani në ndonjë kontest me shfrytëzues të tjerë dhe si e keni zgjidhur atë, e nëse jo, si do ta kishit zgjidhur?

Në hapësirën për diskutim, shfrytëzuesit, zakonisht, i parashtrojnë pyetje kandidatit dhe e japin mendimin e tyre për të. Për atë se sa e suksesshme është kandidatura, vendos pjesa e tretë dhe hapësira për votim, ku çdo kandidat mund të votojë me **Për**, **Kundër** ose **I përmbajtur**.

Rekomandohet që çdo votë të mbështetet me një mendim përmbyllës të shfrytëzuesit, në bazë të diskutimit të zhvilluar, mirëpo të mos shkaktojë krijimin e diskutimit të ri në këtë pjesë. Për kohëzgjatjen e kandidaturës vendos komuniteti, si edhe për shumicën e nevojshme nga votimi, që duhet ta përmbushë kandidatura që të jetë e suksesshme.

Në të kundërtën, kandidatura shpallet e dështuar/jo e suksesshme, ndërsa kandidati njoftohet me një porosi ngushëlluese për arsyen dhe inkurajohet që të mendojë për nominim të sër-



ishëm.

Kandidatura mund të shpallet si e pasuksesshme edhe më herët, nëse kandidati nuk i plotëson kërkesat e vendosura ose nëse konstatohet ndonjë arsye tjetër (për shembull, shkelja e ndonjë rregulle gjatë kohëzgjatjes së kandidaturës, qëndrimi joadekuat ndaj komunitetit gjatë kohëzgjatjes së kandidaturës dhe të ngjashme).

Pasi, kandidatura për përfitim të të drejtave të administratorit do të shpallet e suksesshme, kandidati do të avancohet, me ç'rast do ta fitojë statusin e ri dhe veglat e reja në afat sa më të shkurtër, pas përfundimit të kandidaturës.

Rekomandohet që avancimi i shfrytëzuesit në administrator të përcillet me një rekomandim adekuat.

## Funksionet e administratorit

Funksionet e administratorit ose të drejtat e administratorit janë mundësi plotësuese, me të cilat disponojnë administratorët, e jo edhe ndonjë shfrytëzues tjetër i rëndomtë. Kryesisht bëhet fjalë për vegla të caktuara (mundësi teknike), me të cilat mund të shërbehet administratori, mirëpo edhe disa autorizime të veçanta, të cilat mund t'i kryejë edhe çdo shfrytëzues tjetër, por që janë të rekomanduara për administratorët.


Kështu, funksionet e adminisratorit përfshijnë: fshirjen e faqeve, mbylljen e faqeve për redaktim, redaktimin e disa faqeve teknike, bllokimin e shfrytëzuesve dhe ndërmjetësimin në marrëdhëniet ndërmjet shfrytëzuesve. (në fotografinë 8.1. janë paraqitur funksionet plotësuese me të cilat disponojnë administratorët).



Fotografia 8.1. "Privilegjet" e administratorëve

Fshirja e faqeve është funksion i administratorit që rekomandohet në raste kur ekziston shkelja e qartë e parimit të përmbajtjes së lirë (përmbajtja nuk është e lirë) ose kur futet përmbajtje joadekuata në faqe (vandalizëm, përmbajtje që nuk është shkruar në shkrimin dhe gjuhën e faqes, ose përmbajtje që nuk përkon me titullin e faqes).

Kur do ta fshijë faqen, administratori duhet ta theksojë edhe arsyen përse e bën një gjë të tillë (Fotografia 8.2.).



**Избриши „Александар Станковски“**

Од Википедија, слободната енциклопедија  
← [Александар Станковски](#)

**Предупредување: Страницата којашто сакате да ја избришете има историја со ок 56 ревизи: [Историја на страница](#)**

На пат сте трајно да избришете страница заедно со нејзината историја. Потврдете дека им намера да го направите ова, дека ги разбирате последиците од тоа, дека го правите ова е согласност со [политиката](#).

Бриши

Причина:


Друга/дополнителна причина:

Набљудувај ја оваа страница

*Fotografia 8.2. Fshirja e faqes*

Nevoja për mbylljen ose për mbrojtjen e faqeve paraqitet kur ekziston një luftë redaktuese, e përcjellë me kontest rreth përmbajtjes së ndonjë faqeje të caktuar ose me redaktime të vazhdueshme që e përkeqësojnë përmbajtjen e faqes.

Mbyllja bëhet duke e plotësuar formularin përkatës, me ç'rast duhet të theksohet arsyeja për mbylljen, lloji i mbylljes, dhe periudha kohore gjatë së cilës faqja do të jetë e mbyllur (Fotografia 8.3.).



Redaktimi i faqeve teknike mundëson që të bëhen përshtatje të caktuara që e lehtësojnë funksionimin e tërë projektit. Bëhet fjalë për faqe që gjenden në një hapësirë të veçantë të emrit, me prefiks “MediaWiki”, dhe në mes tjerash i përfshijnë edhe faqet që lidhen me formularin dhe veglën për redaktim.

Rekomandohet që këto faqe të ndryshohen shumë rrallë, e poashtu është e pëlqyeshme që të ekzistojë edhe pëlqim nga ana e komunitetit për këtë. Në këtë hapësirë të emrit bën pjesë edhe faqja për njoftim, me plotësimin e së cilës njoftohet i tërë komuniteti për ndonjë ngjarje aktuale shumë të rëndësishme.

Funksioni (Fotografia 8.4.) me të cilin administratori mund të bllokojë ndonjë shfrytëzues tjetër, është funksioni më jofalënderues i administratorit dhe rekomandohet të përdoret në raste të jashtëzakonshme.

Administratori mund të bllokojë ndonjë redaktues, kontributet e të cilit evidentohen me adresë IP, duke e bllokuar me këtë rast tërë adresën IP ose mund të bllokojë shfrytëzues të regjistruar, duke e bllokuar emrin e shfrytëzuesit.

Nevoja për bllokim, më shpesh, paraqitet për shkak të shkeljes së ndonjë rregulle, vandalizimit të faqeve duke futur përmbajtje joadekuate, e bile edhe në rast se emri i shfrytëzuesit duke qartë se është joadekuat.

Gjithmonë është mirë, që administratori t’ia tërheqë vërejtjen shfrytëzuesit, i cili me kontributet e tia ka bërë shkelje dhe ta inkurajojë që të vazhdojë me redaktime kualitative.

Është mirë që ky veprim të përsëritet disa herë, e nëse ka shkelje të vazhdueshme, atëherë shfrytëzuesi mund të bllokohet.

Ngjashëm si edhe gjatë fshirjes së faqeve, edhe gjatë bllokimit duhet të theksohet arsyeja për këtë, si dhe periudha kohore për të cilën është bllokuar shfrytëzuesi.

Më mirë është që bllokimi i parë të jetë për një periudhë shumë të shkurtër kohore (disa orë deri në disa ditë), dhe në bllokimet e tjera kohëzgjatja të vazhdohet, derisa shfrytëzuesi të bllokohet për afat të pacaktuar.

## Блокирај корисник

Користете го долниот образец за да го забраните пристапот за пишување од одредена IP-адреса или корисничко име. Ова единствено треба да се прави за да се спречи вандализам, во согласност со [правилата на Википедија](#). Изберете конкретна причина подолу (пример: цитирање на конкретни страници што биле вандализирани).

Блокирај корисник

IP-адреса  
или  
корисничко име:

Истек на рокот:

Друг рок:

Причина:

Друга, дополнителна причина:

- Блокирај само анонимни корисници
- Оневозможни создавање кориснички сметки
- Оневозможни го корисникот да праќа е-пошта
- Набљудувај ги корисниците кои доаѓаат од оваа IP-адреса и нивни

Fotografia 8.4. Bllokimi i shfrytëzuesit

---

Ndërmjetësimi gjatë marrëdhënieve ndërmjet shfrytëzuesve është funksion për realizimin e të cilit nuk nevojiten vegla të veçanta të administratorit, kështu që atë mund ta kryejnë edhe shfrytëzues që nuk janë administratorë.

Megjithatë, për shkak të autoritetit të fituar dhe njohurive më të gjera, rekomandohet që ky grup i shfrytëzuesve ta kryejë atë funksion.

Këtu duhet theksuar edhe atë se kryerja e këtij funksioni nuk do të thotë përzierje në komunikimin ndërmjet shfrytëzuesve të tjerë, por pjesëmarrje në diskutimet dhe në votimet e tërë komunitetit ose përkushtim i kujdesit si administrator dhe këshillim në rast të kontestit ndërmjet shfrytëzuesve.

Në vazhdim, janë dhënë dy shembuj në të cilat paraqitet nevoja për kryerje të këtij funksioni, ku i pari është diskutim dhe votim për futje të ndryshimeve, ndërsa i dyti është kontest ndërmjet shfrytëzuesve për futje të përmbajtjes në një artikull të caktuar.

#### Shembulli 1

Unë mendoj se futja e këtyre ndryshimeve është kafshatë tepër e madhe për projektin dhe vetëm do t'i bëjnë dëm punës së projektit.-- Shfrytëzuesi 1

Mendimi im është se zbatimi i këtyre ndryshimeve është i domosdoshëm, sepse nuk kemi kontroll të madh mbi disa fusha kyçe. -- Shfrytëzuesi 2

Mirëpo, a ju kujtohet kur diksutuam për futjen e ndryshimeve paraprake dhe erdhëm në përfundim se nuk është mirë që vazhdimisht të fusim rregulla të reja. -- Shfrytëzuesi 1

*(diskutimi vazhdon me komente jashtë temës)*

**Do t'ju kisha lutur t'i ktheheni temës dhe t'i ndërprisni këto komente që nuk ndërlidhen me temën. -- Administratori**

*(vazhdon votimi)*

**Për** Mendoj se ndryshimet janë shumë të rëndësishme. -- Shfrytëzuesi 3

**Kundër** Ndryshimet do të shkaktojnë zvogëlim të lirisë për redaktim. -- Shfrytëzuesi 4

---

**Për -- Shfrytëzuesi 5**

**A ka mundësi që shkurtimisht ta theksoni arsyen e votës Suaj, sepse votat e pavërtetuara nuk merren parasysh. -- Administratori**  
*(votimi vazhdon)*

*(pas kalimit të afatit për votim)*

**Në bazë të votave të dhëna, votimin e shpall të mbyllur, me ç'rast komuniteti (nuk) i miratoi ndryshimet. -- Administratori**

Shembulli 2

Do t'ju kisha lutur që nëse ka mundësi, dikush të më sqarojë se pse redaktimet e mia në artikull ishin larguar.-- Shfrytëzuesi 1

Redaktimet tuaja u hoqën, sepse nuk ishin nga burime që mund të konsiderohen të besueshme. -- Shfrytëzuesi 2

Mirëpo, burimet duhet të merren parasysh, duke pasur parasysh se në to, tema është përfshirë në mënyrë të shkëlqyeshme. -- Shfrytëzuesi 1

Pajtohem se largimi i përmbajtjes është i pabazë dhe kërkoj të kthehet menjëherë. -- Shfrytëzuesi 3

*(në diskutim kyçen edhe shfrytëzues të tjerë, dhe ajo vazhdon me një ton edhe më të ashpër dhe pa gjasa për zgjidhje të problemit)*

**Së pari, do t'i kisha lutur pjesëmarrësit në këtë diskutim që të jenë më të sjellshëm, ndërsa për burimet mendoj se (nuk) janë adekuate, sepse ato (nuk) paraqesin burim shkencor, dhe për këtë arsye përmbajtja (nuk) duhet të futet në artikull. -- Administratori**

Shembulli i parë paraqet më tepër kryerje teknike të funksionit nga ana e administratorit, kurse gjatë zgjidhjes së kontesteve mund të ndodhë grindje, për zgjidhjen e së cilës nevojitet edhe njohje e fushës konkrete, prandaj, këtu administratori, nëse nuk është profesionist, nuk mund të ketë qëndrim, i cili gjithmonë do të merret parasysh.

Në shembullin konkret, detyra e administratorit është të konstatojë se a janë burimet në përputhje me rregullat e miratuara nga ana e komunitetit.

---

Është shumë me rëndësi të theksohet edhe ajo se, administratorët mundën edhe vetë të përfshihen në diskutim, me ç'rast, mendimi i tyre duhet të shihet si i barabartë me mendimet e shfrytëzuesve të tjerë.

Kështu, në qëndrimet e administratorit për atë se, burimet a janë adekuate apo jo, nga aspekti i bazës së tyre shkencore, duhet të shihet si edhe në qëndrimet e shfrytëzuesve të rëndomtë.

## Burokratët

Përveç administratorëve, burokratët janë grupi i dytë i shfrytëzuesve që posedojnë mundësi plotësuese teknike në raport me grupin e shfrytëzuesve. Bëhet fjalë për grup të shfrytëzuesve, të drejtat e të cilëve janë më të mëdha edhe se ato të administratorëve, dhe prej këtu del se burokratët janë shfrytëzues me status më të lartë në projekt. Ashtu siç administratorët posedojnë mundësi plotësuese teknike në raport me shfrytëzuesit e zakonshëm, kështu edhe burokratët posedojnë mundësi plotësuese në raport me administratorët, ndërsa ky raport është paraqitur në vazhdim.

Shfrytëzuesi - të drejtat e shfrytëzuesit

Administratori - të drejtat e shfrytëzuesit + të administratorit

Burokrati - të drejtat e shfrytëzuesit + të administratorit + të burokratit

Mënyra se si një shfrytëzues mund të bëhet burokrat, zakonisht është e njëjtë me mënyrën se si bëhet administrator. Kështu, më parë përcaktohen kërkesat që duhet të plotësohen, e pastaj parashtrohet kandidatura.

Duhet të kihet kujdes, që kërkesat që i ka përcaktuar komuniteti, e të cilat duhet t'i plotësojnë ata që janë të interesuar ta fitojnë statusin e burokratit, të jenë në nivel më të lartë se sa ato për fitim të statusit të administratorit.

Në këtë mënyrë, do të vijë në shprehje niveli më i lartë që e ka funksioni i burokratit në raport me atë të administratorit.

Nëse i plotëson këto kërkesa, kandidati duhet të parashtrojë kandidaturë, e cila zakonisht është e njëjtë si edhe për kërkim të statusit të administratorit. Zakonisht, rekomandohet që kandidati që konkurren për status të burokratit, të jetë administrator i projektit përkatës.

Kjo, zakonisht nuk vendoset si një prej kërkesave, mirëpo ka mundësi që rezultati i kandidaturës, gjegjësisht se a do të jetë e suksesshme apo jo, të varet nga ajo se a është kandidati administrator apo jo.

## Funksionet e burokratit

Ngjashëm si edhe funksionet e administratorit, funksionet ose të drejtat e burokratit janë mundësi të veçanta me të cilat disponojnë burokratët, e nuk i kanë administratorët dhe shfrytëzuesit e zakonshëm.

Duhet theksuar se bëhet fjalë vetëm për disa mundësi plotësuese teknike, sepse konsiderohet se përvoja e administratorit është e mjaftueshme për përfshirjen e tyre në zgjidhjen e kontesteve, kështu që, nga ky aspekt, burokratët janë të barabartë me administratorët. Si mundësi plotësuese teknike me të cilat disponojnë burokratët, e të cilat do të sqarohen në vazhdim janë: avancimi i shfrytëzuesve të zakonshëm në administratorë, ndryshimi i emrave të shfrytëzuesve dhe miratimi i statusit bot.

Me avancimin e shfrytëzuesve të zakonshëm në administratorë, rritet numri i anëtarëve në grupin e administratorëve. (Fotografia 8.5.). Nevoja për kryerjen e këtij funksioni paraqitet pas çdo kandidature të suksesshme për status të administratorit, me ç'rast rekomandohet që avancimi të shoqërohet me një rekomandim adekuat për shfrytëzuesin e avancuar.

Уреди ги корисничките групи

Менување на корисничките права на корисникот **Buli** ([Разговор](#) | [придонеси](#))

Можете да ги промените групите во кои е овој корисник:

- Маркирано, значи дека корисникот е во групата.
- Немаркирано, значи дека корисникот не е во групата.
- Свезда (\*) означува дека не можете да ја тргнете групата доколку сте ја додале, и обратно.

Член на: [Уредувачи](#)

Подразбран член на: [Автопотврдени корисници](#)

Групи кои не може да ги промените	Групи кои може да ги промените
<input type="checkbox"/> Проверувач	<input type="checkbox"/> бот
<input type="checkbox"/> стјуард	<input type="checkbox"/> администратор*
<input type="checkbox"/> создавач на сметка	<input type="checkbox"/> Бирократ*
<input type="checkbox"/> увозник	<input checked="" type="checkbox"/> уредувач
<input type="checkbox"/> меѓувики увозник	<input type="checkbox"/> оценувач
<input type="checkbox"/> надгледувач	<input type="checkbox"/> IP блок исклучок
<input type="checkbox"/> потврден корисник	<input type="checkbox"/> автопатролер
	<input type="checkbox"/> патролер
	<input type="checkbox"/> автооценувач

Причина:

Fotografia 8.5. Redaktimi i të drejtave të shfrytëzuesit



Ndryshimi i emrit të shfrytëzuesit është funksion që kryhet kur ndonjë shfrytëzues dëshiron ta ndryshojë emrin e tij të shfrytëzuesit, dhe pa mos i humbur kontributet e tij të mëparshme. Zakonisht, kërkesa parashtrohet në faqen për bisedë me ndonjërin nga burokratët, mirëpo mund të parashtrohet edhe në faqe të veçantë për këtë qëllim. Burokratët duhet t'i kushtojnë kujdes të veçantë, e bile edhe të fillojnë diskutim përkatës, rasteve kur kërkohet që ndryshimi të bëhet në ndonjë emër që tashmë ekziston ose në emër që është i papranueshëm për komunitetin.

Siç u tha më lartë, në projekt ekzistojnë edhe të ashtuquajtura bot-e, kontributet e të cilëve përbëhen nga futja automatike e përmbajtjeve. Bot mund të regjistrojë çdo shfrytëzues i interesuar, me ç'rast duhet të parashtrrojë kërkesë për miratim të statusit bot, që zakonisht bëhet në një faqe që është krijuar për atë qëllim. Puna e burokratit është që t'i ndjekë të gjitha kërkesat e reja për miratim të statusit të këtillë dhe t'i miratojë ato. Mirë është të kërkohet edhe përshkrimi i shkurtër i qëllimit të botit dhe në bazë të tij të silltet vendim për miratimin e statusit.

## Keqpërdorimi i funksioneve plotësuese

Avancimi i shfrytëzuesve të zakonshëm në administratorë dhe në burokratë, nuk paraqet vetëm rritje të numrit të shfrytëzuesve me status më të lartë, por edhe rritje të numrit të shfrytëzuesve me të drejta më të mëdha dhe me më shumë funksione që i kanë në dispozicion.

Nënkuptohet, kjo kërkon përgjegjësi më të madhe dhe kryerje të funksioneve përkatëse, vetëm kur paraqitet nevoja për to. Në të kundërtën, kryerja e funksioneve plotësuese kur nuk ka nevojë ose përdorimi i statusit më të lartë me qëllim të nënvlerësimit ose nënçmimit të shfrytëzuesve të tjerë, konsiderohet keqpërdorim i funksionit të besuar.

Zakonisht, ky keqpërdorim përfundon me tërheqje të vërejtjes për administratorin ose burokratin, ndërsa në rastin më të keq, mund të përfundojë edhe me marrje të statusit.

Shembuj të keqpërdorimit të funksionit janë: bllokimi i qëllimshëm i ndonjë shfrytëzuesi pa tërheqje paraprake të vërejtjes dhe pa mos theksuar arsye të bazuar për këtë, fshirja masovike e artikujve pa pëlqim paraprak të komunitetit, mbyllja e panevojshme dhe e paqartë e faqeve për redaktim të artikujve nga shfrytëzuesit e zakonshëm, avancimi i shfrytëzuesve, kandidaturat e të cilëve nuk kanë qenë të suksesshme etj.

Veprimi për të luftuar keqpërdorime të këtilla, përfshin disa faza.

Nëse konstatohet keqpërdorim në kryerjen e ndonjë funksioni plotësues nga ana e administratorit ose burokratit, më parë duhet të shkruhet një vërejtje për administratorin, ku theksohet arsyeja e shkruarjes së saj dhe përmban rekomandim se si të shmangen situata të ngjashme në të ardhmen.

---

Vërejtjen e këtillë duhet ta japë ndonjë administrator me përvojë, i cili i njeh në mënyrë të shkëlqyeshme rregullat për kryerjen e funksioneve të cilat janë keqpërdorur dhe mund të japë rekomandim që kjo të mos përsëritet në të ardhmen.

Nëse pas vërejtjes, administratori ose burokrati vazhdon me keqpërdorimin e funksionit të tij, kalohet në fazën e dytë, gjegjësisht njoftimin e tërë grupit të administratorëve për rastin. Kjo bëhet duke parashtruar kërkesë, që administratorët t'i kushtojnë kujdes faqes me po të njëjtin emër që shërben për atë qëllim, ndërsa kërkesën mund ta parashtrojë cilido qoftë shfrytëzues që ka vërejtur shkelje të rregullave.

Kërkesës duhet t'i përgjigjen i tërë grupi i administratorëve ose burokratëve të projektit, me ç'rast zhvillohet diskutim, ku vendoset për masat që do të ndërmerren. Zakonisht, ai që i ka shkelur rregullat, më parë duhet të marrë vërejtje grupore nga ana e të gjithë administratorëve dhe burokratëve, e pastaj të mendohet për marrjen e autorizimeve të tija.

Marrja e të drejtave të administratorit dhe të burokratit, paraqet formën më të ashpër të dënimit të shfrytëzuesve të avancuar, të cilët e kanë keqpërdorur funksionin e tyre. Kjo, gjithashtu, shpesh ka ndikim të madh mbi punën e tërë projektit dhe për këtë arsye rekomandohet vetëm në raste të jashtëzakonshme.

Marrjen e të drejtave nuk mund ta bëjë ndonjë administrator ose burokrat, por atë e kanë në dispozicion vetëm krijuesit e projektit, ata që i kanë ato mundësi teknike.

Duhet theksuar se shfrytëzuesi që i ka humbur autorizimet e administratorit ose të burokratit, mund të kandidohet përsëri për t'i fituar ato, ndërsa veprimi për atë është i njëjtë si edhe gjatë nominimit të parë. Ndonjëherë, komuniteti mund të vendosë për periudhën kohore pas marrjes së statusit, gjatë së cilës shfrytëzuesi i dënuar nuk ka të drejtë të nominohet, por duhet të presë që të kalojë ajo kohë.

# 10

## Politika

Wiki-teknologjia mundëson që një numër i madh njerëzish të redaktojnë një ose më shumë dokumente ose informata të tjera tekstuale, por edhe multimediale. Shpesh wiki-t, i redaktojnë dhe bashkëpunojnë dhjetëra, qindra, bile edhe mijëra njerëz. Për shkak se wiki-t, zakonisht janë të hapura për redaktuesit, parashtrohet pyetja: si mundet që një numër kaq i madh redaktuesish ta dijnë saktë se çka pritet prej tyre? Si t'i iket situatës që të mos ndodhë kaos, ose wiki të largohet tërësisht nga plani dhe qëllimi i tij fillestar?

Le ta marrim përsëri shembullin e enciklopedisë së lirë Wikipedia.

Që nga fillimet modeste në vitin 2001, sot artikujt e Wikipedia-s nuk rriten vetëm kuantitativisht, por edhe për nga kualiteti. Shumë hulumtime të pavarura tregojnë se, sa i përket kualitetit dhe vërtetësisë, Wikipedia nuk mbetet prapa në krahasim me disa enciklopedi klasike, të cilat kanë traditë disashekullore të standardeve rigorozë redaktuese. Është e qartë se për t'i arritur këto standarde, Wikipedia-s nuk i majfton të ketë teknologji superiore dhe numër të madh redaktuesish dhe administratorësh: i duhet edhe politikë redaktuese.

Si edhe në shumë wiki-projekte të tjera, komuniteti nuk e përcakton vetëm përmbajtjen konkrete, por edhe vetë politikën redaktuese të Wikipedia-s.

Parimet kryesore të Wikipedia-s, gjegjësisht ajo që mund të quhet “kushtetutë” e Wikipedia-s, janë pesë shtyllat e saja:

1. Wikipedia është enciklopedi.
2. Wikipedia ka këndvështrim neutral.
3. Wikipedia është përmbajtje e lirë.
4. Wikipedia-sit duhet të respektohen në mes vete dhe të jenë të njerëzishëm.
5. Wikipedia nuk ka rregulla ngurta.

Nga këto pesë shtylla, me kalimin e kohës, janë përfituar dhjetëra, e bile edhe qindra parime (politika, policies) dhe udhëzime (orientime, guidelines), që zhvillohen nga ana e komunitetit, me qëllim që të përcaktohen mënyrat më të mira për redaktim, të sqarohen parimet, të zgjidhen konfliktet ose në cilëndo qoftë mënyrë tjetër, të arrihet qëllimi për krijim të enciklopedisë së lirë dhe të vërtetë.

Kështu, për shembull, ekziston parimi për atë se çka **nuk është** Wikipedia, gjegjësisht çfarë informatash nuk duhet të futen në Wikipedia. Ekziston edhe parimi i kontrollueshmërisë, i cili kërkon që të gjitha informatat që futen në Wikipedia të mund të kontrollohen, gjegjësisht për to të citohen burime relevante.

---

Çfarë politike redaktuese do të miratojë një wiki-projekt dhe si do të zbatohet ajo, ndikon në mënyrë fundamentale mbi karakterin dhe identitetin e projektit.

Për dallim nga Wikipedia, ueb-faqja WikiTravel, nga redaktuesit kërkon në mënyrë specifike që të mos shkruajnë në stil enciklopedik, sepse artikujt e tij kanë për qëllim të duken si udhëzues turistikë. Pastaj, kërkohet të mos shkruhet në mënyrë promovuese për lokale të caktuara, të mos shkruhet vetëm për përvojat negative nga destinacione turistike, të mos shkruhet shumë për kulturën e popujve (për shkak se përvoja ka treguar se kjo varet shumë nga paragjykimet e atij që shkruan).

Jociklopedia (Uncyclopedia), është një wiki-faqe që paraqet parodi humoristike të Wikipedia-s, e cila kërkon nga redaktuesit e saj që të jenë qesharakë, mirëpo gjithashtu, thuhet edhe se “paragjykimet nuk janë zëvendësim i humorit”.

Politika tepër e butë redaktuese ose, mosekzistimi i saj mund të shkaktojë që të bjerë në ujë qëllimi fillestar i wiki-projektit, shndërrimi i tij në përmbledhje informatash jorelevante dhe konfuze. Politika tepër rigoroze redaktuese, nga ana tjetër, mund ta mbyllë projektin për shfrytëzuesit e rinj potencialë.

Prandaj, në Wikipedia ekziston parimi se “ajo nuk ka rregulla të ngurta të gdhendura në gur”, dhe parimi se “të posaradhurit nuk duhet të sulmohen”, që do të thotë se redaktuesve të rinj u duhet pak kohë, që në tërësi t’i pranojnë të gjitha parimet dhe udhëzimet.

Zbatimi i politikës redaktuese, poashtu është një çështje interesante.

Shumë njerëz konsiderojnë se në wiki-projektet, fjalën kryesore gjatë zbatimit të politikës e kanë administratorët, (shihe pjesën e mëparshme) e në fakt, ata intervenojnë vetëm në disa raste. Funkcionimi i politikës redaktuese është i pamundur pa pranimin dhe zbatimin e saj nga ana e shumicës së redaktuesve të një wiki-projekti. Administratorët janë si policët e trafikut, të cilët e rregullojnë komunikacionin vetëm në raste kur ka tolloni ose gjatë aksidenteve – ndërsa në pjesën tjetër të kohës, pritët që vozitësit të vozisin me kujdes dhe në mënyrë të ndërgjegjshme.